

VENDIM
Nr. 2, datë 6.1.2020

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË GRANTIT, NDËRMJET KËSHILLIT
TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SUEDISË, PËR
FORCIMIN E KAPACITETEVE TË AGJENCISË SË MENAXHIMIT TË
BURIMEVE UJORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së grantit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Suedisë, për forcimin e kapaciteteve të Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

MARRËVESHJE
NDËRMJET SUEDISË DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË, PËR FORCIMIN E KAPACITETEVE TË AGJENCISË SË
MENAXHIMIT TË BURIMEVE UJORE

Tabela e përmbajtjes

1. Objekti dhe historiku
2. Objektivat e projektit
3. Zbatimi
4. Granti
5. Disbursimet
6. Menaxhimi financiar
7. Raportimi financiar
8. Raporti narrativ
9. Prokurimet
10. Monitorimi
11. Takimet konsultuese dhe vlerësuese
12. Vlerësime
13. Auditimi
14. Rikthimi i interesave, fitimeve nga kursi i këmbimit dhe fondeve të papërdorura
15. Korrupsioni dhe parregullsi të tjera
16. Zgjidhje ligjore
17. Vizibiliteti dhe informacioni
18. Referenca në marrëveshje të tjera
19. Zgjidhja
20. Periudha e vlefshmërisë së Marrëveshjes
21. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve
22. Njoftime

Kjo Marrëveshje Granti lidhet ndërmjet:

1. Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë (Marrësi); dhe

2. Suedisë, përfaqësuar nga Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (Suedia) për forcimin e kapacitetit institucional të Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, AMBU-ja.

Së bashku, referuar si Palët.

1. Objekti dhe historiku

1.1 Në vitin 2006, Shqipëria dhe Suedia nënshkruan një Marrëveshjeve mbi të drejtat dhe detyrimet e përgjithshme për zhvillim e bashkëpunim. Suedia ka vendosur të japë një kontribut në formë granti, i cili do të përdoret vetëm për qëllim të zbatimit të projektit: “Forcimi i kapaciteteve institucionale të Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore”. Projekti do të zbatohet përgjatë një periudhe 42-mujore, duke filluar nga data që kjo Marrëveshje hyn në fuqi.

1.2 Palët bien dakord të nënshkruajnë këtë Marrëveshje, e cila përmban kushtet specifike dhe shtojcat përkatëse, të cilat janë pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje dhe janë renditur në bazë prioritetesh. Në rast mospërputhshesh mes kushteve specifike dhe anekseve, kushtet specifike do të kenë epërsi.

Shtojca:

A. Dokumenti i Projektit, që përmban përshkrimin.

B. Buxheti.

C. Termat standardë të Referencës së SIDA-s për auditimin vjetor.

2. Objektivat e Projektit

2.1 Objektivi kryesor i këtij projekti është transformimi i AMBU-së në një institucion funksional, efektiv dhe efikas që përmbush detyrimet ligjore, detyrat dhe përgjegjësitë siç përshkruhen në dokumentin e projektit: “Forcimi i kapacitetit institucional të AMBU-së”, i datës 12 shkurt 2019, shtojca A.

2.2 Dokumenti i projektit, përfshirë kornizën e rezultateve, si dhe buxheti në monedhën euro, mund të ndryshohen me shkrim, sa herë që konsiderohet e nevojshme për një zbatim sa më efektiv.

3. Zbatimi

3.1 Marrësi, nëpërmjet AMBU-së, është përgjegjës për zbatimin e projektit dhe menaxhimin e kontributeve financiare të Suedisë. Suedia si financuese nuk mban asnjë përgjegjësi dhe/ose detyrim ndaj asnjë pale të tretë në lidhje me zbatimin e projektit.

3.2 Organizimi institucional dhe të tjera

3.2.1 Marrësi sigurohet se AMBU-ja zbaton aktivitetet e projektit në përputhje me këtë Marrëveshje.

3.2.2 Marrësi sigurohet se përgjatë zbatimit të projektit, Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, Bankës Botërore dhe Donatorëve të tjerë (DPFKF), në varësi të Ministrisë Financave dhe Ekonomisë, kryen aktivitete *fiduciary* (prokurime dhe aktivitete financiare), mbështetur sipas nevojës nga AMBU-ja, përfshirë monitorimin dhe vlerësimin e Projektit.

3.2.3 Do përgatitet një manual operacional, i cili do specifikojë në hollësi mënyrën e organizimit për zbatimin institucional dhe format e tjera. AMBU-ja dhe Suedia bien dakord për Manualin Operacional, brenda 30 ditësh pasi është nënshkruar Marrëveshja e Grantit.

4. Granti

4.1 SIDA merr përsipër të financojë projektin me një grant që nuk kalon shumë prej 19.700.000 SEK (nëntëmbëdhjetë milionë e shtatëqind mijë korona suedeze) (Granti), sipas ndarjeve buxhetore të parlamentit suedez.

4.2 Granti do të përdoret vetëm për qëllim financimi të kostove aktuale që rrjedhin nga zbatimi i projektit përgjatë periudhës së zbatimit të tij.

4.3 Marrësi, nëpërmjet AMBU-së, ka përgjegjësinë të sigurojë burime shtesë që mund të nevojiten për një zbatim sa më të mirë të projektit. Kjo pasqyrohet në Buxhet, shtojca B, dhe përfshihet në raportim.

5. Disbursimet

5.1 Disbursimet kryhen në varësi të përmbushjes së kushteve të kësaj Marrëveshjeje, ecurisë në përmbushjen e objektivave dhe rezultateve të pritshme të Projektit, fondeve të përdorura sipas datës së kërkesës për disbursim, si dhe nevojave aktuale financiare bazuar në planin vjetor të punës dhe buxhetin e paraqitur.

5.2 Suedia do të përpiqet të sigurojë parashikueshmërinë e financimit të saj duke përafruar angazhimet e veta financiare vjetore dhe disbursimet me ciklin buxhetor të Marrësit dhe nevojat për fluks monetar të AMBU-së.

5.3 Granti do të lëvrohet në këste gjashtëmujore sipas nevojave financiare të Projektit për periudhën pasardhëse. Nevojat financiare i referohen shpenzimeve të buxhetuara për periudhën vijuese, pa përfshirë fondet që ka në dispozicion Projekti nga burime të tjera për të njëjtën periudhë.

5.4.1 Fondet e ofruara nga Suedia paguhen në këste, pas marrjes dhe miratimit të kërkesës me shkrim për pagesë, e nënshkruar nga përfaqësuesi i autorizuar për Marrësin sipas specifikimeve në paragrafin 5.4.2 më poshtë.

5.4.2 Një kërkesë me shkrim që përmban titullin e Marrëveshjes dhe numrin identifikues të kontributit, të specifikuar në preambulën e kësaj Marrëveshjeje, do të dërgohet Ambasadës. Kërkesa nënshkruhet nga përfaqësuesit e autorizuar të caktuar nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë.

Shuma e kërkuar do të jetë në monedhën suedeze (SEK) pavarësisht se në çfarë monedhe lëvrohet pagesa. Pagesa lëvrohet në monedhën e preferuar, të specifikuar nga Marrësi në kërkesë.

a) Pagesa bëhet në monedhë të këmbeshme, përveç SEK, në rastet kur është specifikuar qartë në kërkesë dhe nëse llogaria bankare e këmben monedhën e specifikuar. Kursi i këmbimit i SEK do të kryhet nga banka e SIDA-s në bazë të udhëzimeve të SIDA-s për kryerjen e pagesave.

Kërkesa përmban detajet e llogarisë bankare si më poshtë:

- emrin e bankës;
- mbajtësin e llogarisë bankare;
- numrin e llogarisë bankare;
- IBAN (në rast se ka);
- SWIFT/*Bic-code*;
- monedhën e llogarisë.

5.4.3 Kërkesa e parë shoqërohet me një letër të cilën banka ja dërgon SIDA-s ku e garanton se detajet bankare sa më sipër janë të sakta. Kërkesat vijuese për lëvrim shoqërohen me letër nga banka vetëm në rastet kur Marrësi ka ndryshuar detajet e llogarisë bankare më sipër.

5.5 Pagesa e parë prej 3 milionë koronash suedeze do të depozitohet në llogarinë bankare, të specifikuar pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje.

5.6 Pagesa e dytë kryhet pas marrjes dhe aprovimit të Raportit Fillestar, siç parashikohet në paragrafin 8.2 më poshtë.

5.7 Pagesat vijuese kryhen në bazë të kërkesave për raportim, të parashikuara në këtë Marrëveshjeje, si dhe nevojave për likuiditet sipas planeve vjetore të punës dhe buxheteve vjetore.

5.8 Fondet e ofruara nga Suedia lëvrohen në një llogari të posaçme në Bankën e Shqipërisë e cila është në emër të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Marrësi, nëpërmjet AMBU/DPFKF, njofton menjëherë Suedinë me shkrim për marrjen e fondeve. Njoftimi përmban shumën dhe monedhën në të cilën ka mbërritur, si dhe shumën ekuivalente të kredituar në monedhën vendëse.

5.9 AMBU-ja konfirmon se financimi i ofruar nga Suedia, do të përdoret vetëm për qëllim të mbulimit të shpenzimeve të alokuara të Projektit siç detajohet në Dokumentin e Projektit.

6. Menaxhimi financiar

Marrësi, nëpërmjet DPFKF-së, përdor një sistem të përshtatshëm të menaxhimit financiar për Projektin, në përputhje me legjislacionin vendës që zbaton edhe administrata publike në Shqipëri. Të ardhurat dhe kostot e Projektit duhet të jenë lehtësisht të gjurmueshme dhe të verifikueshme. Kostot duhet të përfshihen në parashikimin e përgjithshëm buxhetor dhe të jenë të nevojshme për zbatimin e Projektit.

7. Raportimi financiar

7.1 Përfituesi, nëpërmjet DPFKF-së, përgatit dhe i dërgon Suedisë pasqyra financiare gjashtëmujore, si dhe raportet financiare të Projektit, jo më vonë se data 31 mars dhe 31 shtator të çdo viti. Periudha e parë financiare që mbulon vitin 2019, nuk dorëzohet më vonë se data 31 mars 2020. Raporti përfundimtar financiar mbulon periudhën nga 1 korriku 2021, deri më 31 mars 2022 dhe nuk dorëzohet më vonë se data 30 qershor 2022.

7.2 Pasqyrat financiare/raportet financiare përmbajnë të ardhurat aktuale dhe kostot duke i krahasuar me buxhetin e aprovuar për periudhën e raportimit dhe e pasqyrojnë financimin nga Suedia në mënyrë e detaje të tilla që lejojnë identifikimin e disbursimeve të rëna dakord për Projektin. Pasqyrat financiare/raportet financiare nënshkruhen nga drejtori i përgjithshëm i DPFKF-së.

7.3 Pasqyrat financiare gjashtëmujore dhe raportet financiare përmbajnë informacion rreth shumës së mbërritur, si në monedhën e transfertës dhe për shumën në monedhën vendëse, kursin e këmbimit dhe datën kur është kredituar shuma.

7.4 Raporti përmban gjithashtu informacion për shpenzimet totale të ndara sipas zërave të miratuara të buxhetit, për periudhën e raportimit, si dhe shumën totale për gjithë periudhën e Projektit.

8. Raporti narrativ

8.1 Përfituesi, nëpërmjet DPFKF-së, në bashkëpunim me AMBU-në i dorëzon Suedisë me shkrim raportin fillestar, jo më vonë se data 31 mars 2020.

8.2 Raporti fillestar përmban propozim më të detajuar të aktiviteteve të projektit, një kornizë rezultatesh të rishikuar dhe buxhet më të hollësishëm.

8.3 Marrësi, nëpërmjet DPFKF-së dhe AMBU-së i dorëzon Suedisë me shkrim raportin gjashtëmujor narrativ, jo më vonë se data 31 mars dhe 30 shtator të çdo viti.

8.4 Raporti narrativ përmban edhe një analizë të ecurisë së aktiviteteve dhe rezultateve të pritshme të projektit, sipas strukturës së dokumentit të projektit (korniza e rezultateve që gjendet më të detajuar në planet gjashtëmujorë të punës).

8.5 Raporti gjashtëmujor mbulon periudhën nga data 1 janar deri më 30 qershor dhe nga data 1 korrik deri më 31 dhjetor. Raporti gjashtëmujor përmban përmbledhje të përgjithshme për gjithë periudhën e projektit për:

- aktivitetet e realizuara gjatë periudhës së raportimit;
- produktet e realizuara kundrejt produkteve të planifikuara;
- objektivat e përmbushur të rezultateve kundrejt objektivave të planifikuara të rezultateve ose ecurinë në përmbushjen e objektivave të rezultatit, si dhe një vlerësim të probabilitetit për përmbushjen e objektivit të planifikuara të rezultatit;
- një vlerësim të faktorëve të riskut që mund të pengojnë përmbushjen e objektivave; dhe
- një vlerësim të ndryshimeve të mundshme që mund të ndodhin gjatë zbatimit të projektit, përfshirë menaxhimin e riskut.

8.6 Marrësi, nëpërmjet DPFKF-së dhe në bashkëpunim me AMBU-në, dërgon Suedisë raportin përfundimtar me shkrim, jo më vonë se gjashtë muaj pas datës së përfundimit të projektit. Raporti përfundimtar përmban një përmbledhje të përgjithshme për të gjithë periudhën e zbatimit të aktiviteteve të:

- produkteve të realizuara kundrejt produkteve të planifikuara;
- objektivin e përmbushur të rezultateve kundrejt objektivit të planifikuar të rezultateve;
- një vlerësim të faktorëve që kanë ndikuar në përmbushjen e objektivave;
- mësimet e nxjerra nga zbatimi i projektit, dhe një vlerësim të nevojave për ndryshime, në një fazë të re, të mundshme të projektit, përfshirë edhe masat për zvogëlimin e riskut.

8.7 Marrësi siguron çdo informacion të rëndësishëm që lidhet me zbatimin e projektit, siç kërkohet nga Suedia.

9. Prokurimet

Marrësi, nëpërmjet DPFKF-së dhe në bashkëpunim me AMBU-në, prokuron zërat që nevojiten për projektin në përputhje me udhëzimin PRAG, “Prokurimi dhe grantet në politikën e jashtme të BE-së — një udhëzues praktik”, e zbatueshme që prej 2 gushtit 2018. Hapat e mëposhtëm mbi procedurat e prokurimit dhe mënyrën e zbatimit kërkojnë aprovimin paraprak të Suedisë:

- termat e referencës dhe specifikimet teknike për të gjithë aktivitetet e projektit;
- raportin e vlerësimit përfshirë pjesën teknike dhe financiare dhe;
- çdo shtesë në kontratë që rrit vlerën e kontratës mbi 20% nga vlera fillestare.

Manuali operacional do përshkruajë me detaje mënyrën e prokurimit dhe përgjegjësitë që ka SIDA, DPFKF-ja dhe AMBU-ja.

10. Monitorimi

10.1 Marrësi, nëpërmjet AMBU-së, është përgjegjës për monitorimin e ecurisë dhe të performancës së projektit, si dhe për përmbushjen e produkteve dhe rezultateve të pritshme.

10.2 Suedia monitoron përputhshmërinë dhe performancën në bazë të kësaj Marrëveshjeje.

10.3 Procesi i rishikimit të ecurisë së Projektit do të harmonizohet me procesin e rishikimit nga ana e Marrësit.

10.4 Marrësi dhe Suedia do të mbajnë komunikim të ngushtë për mbështetjen dhe zbatimin e projektit.

11. Takimet konsultuese dhe vlerësuese

11.1 Palët bashkëpunojnë dhe komunikojnë rregullisht për çdo çështje që lidhet me zbatimin e projektit dhe të kësaj Marrëveshjeje.

11.2 Palët takohen çdo gjashtë muaj për të diskutuar zbatimin e projektit. Takimet organizohen dhe drejtohen nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore.

11.3 Kostot e takimeve mbulohen nga buxheti i projektit.

11.4 Temat kryesore që do të diskutohen gjatë konsultimeve përfshijnë:

- rezultatet e arritura, përfshirë forcimin e AMBU-së dhe pozicionin e saj në sektorin e burimeve ujore;
- integrimin e çështjeve ndër sektoriale në funksionet dhe kapacitetet e AMBU-së.

11.5 Rezultatet e takimit zbardhen në procesverbalin e rënë dakord. Procesverbali i rënë dakord hartohet nga AMBU-ja dhe një draft i dërgohet Suedisë për aprovim dhe komente, brenda dy javësh nga data e takimit. Suedia informon AMBU-në për miratimin dhe komentet brenda 10 ditësh nga marrja e draftit.

11.6 Marrësi ose Suedia mund të kërkojnë takime të tjera konsultuese, nëpërmjet DPFKF-së dhe AMBU-së, për çdo çështje që lidhet me zbatimin e projektit.

11.7 Marrësi, nëpërmjet DPFKF-së, njofton menjëherë me shkrim Suedinë për çdo rrethanë që pengon ose rrezikon të pengojë zbatimin e suksesshëm të projektit, apo për çdo ndryshim tjetër, me qëllim zgjidhjen e problemit dhe kërkon takim për të informuar dhe konsultuar Suedinë mbi masat korrigjuese që do të ndërmerren, në rast nevojë.

12. Vlerësimet

12.1 Nëse Suedia kryen misione të tjera, të ndërmjetme ose pas faktit (*ex-post*) apo misione monitorimi, DPFKF-ja dhe AMBU-ja marrin përsipër t'i sigurojnë misionit monitorues ose

vlerësues çdo dokument apo informacion mbështetës dhe i japin të drejtën të ketë akses, siç parashikohet në këtë Marrëveshje.

12.2 Nëse njëra prej Palëve kryen apo nënkontrakton një vlerësim, gjatë kohëzgjatjes së projektit, Pala tjetër informohet paraprakisht dhe i dorëzohet një kopje e raportit të vlerësimit.

12.3 Kostot për vlerësimin që kërkohet ose nënkontraktohet nga Suedia mbulohen nga kjo e fundit.

13. Auditimi

13.1 Auditimi i jashtëm paguhet nga projekti dhe kryhet nga një auditor i jashtëm, i pavarur dhe i kualifikuar. Auditimi kryhet në përputhje me standardet ndërkombëtare të miratuara nga Organizata Ndërkombëtare për Institucionet e Lartë të Auditimit (INTOSAI) ose Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve (FNK) ose në përputhje me standardet e krahasueshme kombëtare.

13.2 Marrësi, nëpërmjet DPFKF-së, i dërgon Suedisë një kopje të raportit të auditimit dhe dokumentin e menaxhimit që paraqet firma e auditimit.

13.3 Auditimi kryhet nga një auditor i jashtëm, i pavarur dhe i kualifikuar. Termat standardë të referencës së SIDA-s për auditimin financiar, shtojca D, përdoren si referencë dhe termat përfundimtarë të referencës dhe aprovohen nga Suedia. Raporti i auditimit, përfshirë dokumentin e menaxhimit i dërgohet Suedisë jo më vonë se data 30 prill e çdo viti. Auditimi i parë mbulon vitin 2019 dhe nuk dërgohet më vonë se data 30 prill 2020. Auditimi i fundit mbulon periudhën nga 1 janari 2021, deri më 31 mars 2022 dhe nuk dërgohet më vonë se data 31 gusht 2022.

13.4 Marrësi, nëpërmjet DPFKF-së, i dërgon Suedisë raportin e auditimit, si dhe dokumentin e menaxhimit jo më vonë se 14 ditë para datës së planifikuar të takimit konsultues të radhës, të përshkruara më sipër, dhe për çdo rast jo më vonë se (për shembull) gjashtë muaj pas përfundimit të vitit fiskal që mbulon ky raport. Nëse raporti i auditimit përmban rekomandime, qeveria, brenda tre javësh, i dorëzon Suedisë një Plan Menaxhimi, përfshirë Planin e Veprimit.

13.5 Suedia mund të nënkontraktojë ose të kërkojë në çdo kohë auditime të tjera (si auditimi i prokurimeve ose auditime të posaçme për të konstatuar shkelje), aktivitete mbështetëse ose studime financiare. Qeveria bashkëpunon me Suedinë dhe e ndihmon për këto auditime. Kostot e auditimeve shtesë mbulohen nga Suedia.

14. Rikthimi i interesave, fitimeve nga kursi i këmbimit dhe fondeve të papërdorura

14.1 Në përfundim të periudhës së aktiviteteve, çdo fond i papërdorur që kalon vlerën e 500 SEK i rikthehet sa më shpejt SIDA-s dhe për çdo rast jo më vonë se 45 ditë kalendarike pasi SIDA i dërgon Marrësit njoftimin për rikthimin e fondeve. Rikthimi përfshin interesat nga të ardhurat, fitimet nga kursi i këmbimit dhe çdo përfitim tjetër financiar për llogari të grantit, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe.

14.2 Marrësi, nëpërmjet DPFKF dhe AMBU-së, ka përgjegjësinë të garantojë se çdo fond që është dërguar te partnerët për zbatim dhe që ka mbetur i papërdorur në fund të periudhës së aktiviteteve, do t'i rikthehet SIDA-s.

14.3 Rikthimi i fondeve kryhet në llogarinë e caktuar të SIDA-s për rikthimin e fondeve, detajet e së cilës jepen nga SIDA sipas kërkesës.

14.4 Transaksioni do të përmbajë në mënyrë të qartë përshkrimin “Fonde të papërdorura”. Në të vendoset emri i Marrësit, krahas numrit të kontributit dhe titullit të marrëveshjes së SIDA-s,

15. Korrupsioni dhe parregullsi të tjera

15.1 Palët punojnë në mënyrë aktive për të parandaluar korrupsionin dhe parregullsi të tjera në projekt. Ky detyrim vlen për të gjithë personelin, konsulentët dhe për personelin që nuk është pjesë e stafit.

15.2 Korrupsion dhe parregullsi të tjera i referohet të gjitha llojeve të:

a) formave të korrupsionit, përfshirë ryshfetin, nepotizmin, bakshisheve të paligjshme dhe çdo formë tjetër shpërdorimi me besimin, detyrën dhe pozicionin kundrejt përfitimeve të parregullta;

b) shpërdorimit të vlerave monetare, inventarëve dhe të gjithë aseteve të tjera;

c) mashtrimit me pasqyrat financiare dhe jo financiare;

d) çdo përdorim të fondeve që nuk është në përputhje me planin e punës dhe buxhetin.

15.3 Palët:

a) marrin parasysh rrezikun nga korrupsioni dhe parregullsitë e tjera kur planifikojnë dhe zbatojnë projektin dhe evidentojnë risqet kyçe dhe masat për zvogëlimin e tyre. Nëse evidentohet një risk i konsiderueshëm nga korrupsioni apo parregullsi të tjera, merren masa për zvogëlimin e riskut në mënyrë që të reduktohet;

b) organizojnë veprimtarinë dhe sistemin e kontrollit të brendshëm në formë të atillë që parandalon, menaxhon dhe zbulon rastet korruptive dhe parregullsitë e tjera;

c) bëjnë të pamundurën për të parandaluar dhe ndaluar korrupsionin dhe parregullsitë e tjera në projekt;

d) i kërkojnë personelit të përfshirë në projekt, furnitorëve dhe kontraktorëve që financojnë projektin, që të mos përfshihen në akte korruptive dhe parregullsi të tjera.

15.4 Marrësi, nëpërmjet AMBU-së dhe DPFKF informon menjëherë SIDA-n për çdo shenjë korrupsioni apo parregullsi të tjera në projekt apo që lidhen me të.

15.5 Marrësi, nëpërmjet AMBU-së dhe DPFKF merr përsipër të hetojë praninë e akteve korruptive apo parregullsive të tjera dhe merr masa, përfshirë masat ligjore kundër personave për të cilët ka arsye për të dyshuar se janë përfshirë në korrupsion apo parregullsi të tjera. Pas kësaj, Palët konsultojnë vazhdimisht njëra tjetrën për mënyrën e trajtimit të çështjes.

16. Zgjidhjet ligjore

16.1 Në rastet kur Marrësi nuk respekton dispozitat e kësaj marrëveshjeje, Suedia ka të drejtën të ushtrojë zgjidhjet e mëposhtme ligjore, përfshirë ndërprerjen e disbursimeve të mëtejshme dhe/ose reduktimin e disbursimeve të reja, mund të kërkojë rikthimin e fondeve ose ndërprerjen e mbështetjes ndaj projektit.

16.2 Në rastet e mosrespektimit të marrëveshjes, Suedia mund të zgjidhë marrëveshjen me shkrim me një njoftim dymujor.

16.3 Në rastet e shkeljeve të rënda të marrëveshjes, Suedia mund të zgjidhë marrëveshjen me efekt të menjëhershëm.

16.4 Në rastet e zgjidhjes së marrëveshjes nga Suedia, zgjidhja nuk aplikohet për fondet e angazhuara në mënyrë të pakthyeshme, në mirëbesim nga Marrësi drejt palëve të treta para datës së njoftimit për zgjidhjen e marrëveshjes, në rast se angazhimet janë kryer në përputhje me këtë marrëveshje.

16.5 Çdo zgjidhje kontrate bëhet me anë të një njoftimi me shkrim që njofton për zgjidhjen e Marrëveshjes.

17. Vizibiliteti dhe informacioni

17.1 Marrësi, nëpërmjet AMBU-së, sa herë që i referohet aktiviteteve, të financuara qoftë pjesërisht apo plotësisht në përputhje me këtë marrëveshje, pranon dhe bën publike se aktivitetet janë financuar nëpërmjet Ndihmës Suedeze për Zhvillim.

17.2 Logoja e Suedisë përdoret në materialet informative dhe lidhje me aktivitetet informuese.

17.3 Prodhimi i këtyre materialeve është plotësisht përgjegjësi e Marrësit dhe përgjegjësia për përmbajtjen i takon botuesit. “Sida” ose “Suedia” nuk mund të përdoret në asnjë mënyrë që mund të sjellë perceptimin sikur SIDA apo Suedia kanë marrë pjesë në prodhimin ose mbështetjen çfarëdo mendimi të paraqitur.

17.4 SIDA dhe drejtori të tjera të administratës suedeze jashtë vendit kanë të drejtën të kopjojnë dhe të shpërndajnë këto materiale nëse është e nevojshme.

18. Referimi në marrëveshje të tjera

Bashkëpunimi ndërmjet Palëve, sipas kësaj Marrëveshjeje rregullohet edhe nga:

- Marrëveshja mbi të Drejtat dhe Detyrimet e Përgjithshme për Zhvillimin e Bashkëpunimit ndërmjet Palëve për periudhën nga data 30 qershor 2006, e deri në momentin e zgjidhjes me njoftim me shkrim nga secila prej Palëve gjashtë muaj para;

- Marrëveshja për Zhvillim dhe Bashkëpunim ndërmjet Palëve për periudhën nga 6 shkurti 2016, deri në 31 dhjetor 2020; dhe
- Çdo marrëveshje që mund të zëvendësojë ose të ndryshojë marrëveshjet e mësipërme.

19. Zgjidhja

19.1 Kjo Marrëveshjet mbetet në fuqi deri në 42 muaj pas hyrjes në fuqi, përveç rasteve kur zgjidhet me shkrim gjashtë muaj para nga një prej Palëve.

19.2 Në rastin e zgjidhjes së marrëveshjes nga Marrësi, gjashtë muaj pas marrjes së njoftimit me shkrim, nuk vendosen më fonde në dispozicion për aktivitetet.

19.3 Të gjitha të drejtat dhe detyrimet në zbatim të kësaj Marrëveshjeje mbeten të pandryshueshme deri në rikthimin e fondeve të mbetura/balancit drejt Suedisë dhe përmbushjes së detyrimeve për raportim sipas kësaj Marrëveshjeje, kohë në të cilën përfundon edhe kjo Marrëveshje.

20. Periudha e vlefshmërisë së marrëveshjes

20.1 Marrëveshja hyn në fuqi pas komunikimit me shkrim nga ana e Marrësit për përfundimin e procedurave të brendshme dhe mbetet në fuqi për të paktën 42 muaj nga data e fillimit të saj, përveç rasteve kur zgjidhet sipas dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, ose deri në momentin që kthehen fondet e papërdorura të SIDA, si dhe përmbushen detyrimet për raportim sipas kësaj Marrëveshjeje, kohë në të cilën përfundon edhe Marrëveshja.

20.2 Zgjidhja ose përfundimi i Marrëveshjes nuk zgjidh palët nga detyrimet përgjegjësitë që rrjedhin nga çdo veprim apo akt i kryer para zgjidhjes apo përfundimit të kësaj Marrëveshjeje.

21. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Nëse lindin mosmarrëveshje ndërmjet palëve nënshkruese në lidhje me interpretimin, aplikimin apo zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, palët konsultohen për të arritur një zgjidhje miqësore.

22. Njoftime

Çdo komunikim në lidhje me këtë marrëveshje bëhet me shkrim, dhe përmban numrin e kontributit dhe titullin e Projektit dhe dërgohet në adresën më poshtë:

Për Suedinë

Ambasada e Suedisë në Tiranë, rruga “Pjetër Budi” 56, Tiranë

Drejtuar Tomas Nystrom

Për Marrësin

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, bulevardi “Dëshmorët e Kombit” nr. 3, Tiranë

Kjo Marrëveshje është nënshkruar në gjuhën angleze në dy kopje origjinale, një për secilën nga Palët Nënshkruese.

Tiranë

14.10.2019

Vendi dhe data

Tiranë

14.10.2019

Vendi dhe data

Për Suedinë, përfaqësuar nga Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (SIDA)	Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Nënshkrimi	Nënshkrimi
Ambasador Elsa Mstad	Ministër Anila Denaj

SHTOJCË A
FORCIMI I KAPACITETEVE INSTITUCIONALE TË AMBU-së
PROJEKTPROPOZIMI PËRFUNDIMTAR (12 SHKURT)

Tabela e përmbajtjes

Tabela e përmbajtjes

Lista e shkurtimeve dhe akronimeve

Përmbledhje ekzekutive

1. Hyrja dhe historiku

1.1 Mbështetje dypalëshe në sektorin e ujit

1.1.1 Bashkëpunimi me asistencat e tjera në sektorin e ujit

1.2 Konteksti i Shqipërisë dhe sektori i ujërave

1.3 Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU)

1.3.1 Riorganizimi i AMBU-së

1.3.2 Qëllimi dhe misioni i AMBU-së

1.3.3 Përgjegjësitë e AMBU-së

1.3.4 Bashkëpunimi i AMBU-së me aktorët

1.3.5 Nevojat për zhvillim të mëtejshëm të punës

1.4 Elemente kyç joteknike për t'u konsideruar

1.4.1 Elementet mjedisore, sociale/gjinore dhe të drejtat në investimet ujore

1.4.2 Ndryshimi i mjedisit/klimës dhe ujërat

1.4.3 Barazia gjinore dhe ujërat

2. Projektpropozimi 2019–2020

2.1 Sfidat për t'u trajtuar

2.2 Aktorët kryesorë

2.3 Përdoruesit kryesorë të ujërave

2.4 Impakti i projektit tek AMBU-ja

2.5 Teoria e Ndryshimit (TN)

2.6 Aktivitetet dhe rezultatet e projektit

2.7 Integrimi i çështjeve ndërsektoriale

2.7.1 Ndryshimi i mjedisit/klimës

2.7.2 Aspektet sociale dhe barazia gjinore

2.8 Risqet dhe zbutja e risqeve

3. Planifikimi i aktiviteteve

4. Menaxhimi i projektit në AMBU

4.1 Organizimi i mënyrës së zbatimit

4.2 Sistemi për monitorimin dhe ndjekjen

5. Menaxhimi financiar

5.1 Buxheti

5.2 Mekanizmi i raportimit financiar

Shtojcë 1. Korniza e rezultateve

Lista e shkurtimeve dhe akronimeve

ADA Agjencia Austriake për Zhvillim

AMBU Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore

ASIG Agjencia Shtetërore për Informacionin Gjeohapësinor

VKM Vendim i Këshillit të Ministrave

DAP Departamenti i Administratës Publike

BE	Bashkimi Evropian
GMIP	Grupi për Menaxhimin e Integruar të Politikave
MIBU	Menaxhimi i Integruar i Burimeve Ujore
NjQV	Njësitë e Qeverisjes Vendore
MBZHR	Ministria e Bujqësisë dhe e Zhvillimit Rural
MFE	Ministria e Financës dhe Ekonomisë
MOG	Grupi Magnum Opus
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
MD	Ministria e Drejtësisë
MB	Ministria e Brendshme
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
AKSHI	Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit
NANR	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore
NAWSW	Agjencia Kombëtare e Furnizimit me Ujë dhe Infrastrukturën Ujore
OJQ	Organizata joqeveritare
OZHQ	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm
NSMIBU	Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore
KKU	Këshilli Kombëtar i Ujit
PM	Kryeministri
ABU	Agjencia e Basenit Ujor
KBU	Këshilli i Basenit Ujor
PMBU	Planet e Menaxhimit të Baseneve Ujore
SIDA	Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar
ISHU	Inspektorati Shtetëror i Ujërave
TN	Teoria e Ndryshimit
STKKU	Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit
ZABU	Zyrat e administrimit të baseneve ujore

Përmbledhje ekzekutive

Ky dokument është një propozim për të mbështetur forcimin e kapacitetit institucional të Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore në Shqipëri (AMBU). Propozimi është përgatitur nga AMBU-ja dhe i dërgohet për mbështetje financiare Agjencisë Suedeze për Zhvillim e Bashkëpunim Ndërkombëtar (SIDA). Qëllimi i programit, i cili do të zbatohet nga AMBU-ja me mbështetjen e një kompanie ndërkombëtare konsulente për ngritjen e kapaciteteve, është të transformojë AMBU-në në një institucion plotësisht funksional, efektiv dhe efikas që përmbush detyrimet ligjore, detyrat dhe përgjegjësitë.

Programi përmban rezultatet dhe produktet e pritshme si më poshtë:

Rezultati i pritshëm afatshkurtër 1: Funksionim i brendshëm i përmirësuar i AMBU-së, ndërmjet drejtorive, sektorëve dhe pozicioneve specifike të punës.

Produkti 1.1 Zhvillimi, pranimi dhe komunikimi i planifikimit dhe organizimit strategjik të AMBU-së;

Produkti 1.2 Zhvillimi i procedurave për funksionimin e brendshëm, përfshirë përcaktimin e roleve dhe përgjegjësi;

Produkti 1.3 Kapacitete të forcuara për të trajtuar çështjet ndërsektoriale si pjesë përbërëse e menaxhimit të burimeve ujore (në veçanti në lidhje me konfliktin, barazinë gjinore, ndryshimin e mjedisit/klimës);

Produkti 1.4 Zhvillimi i strukturave të brendshme të komunikimit dhe sistemeve për të mbështetur proceset e vendimmarrjes;

Produkti 1.5 Ngritja e infrastrukturës së përshtatshme tek AMBU-ja;

Rezultati i pritshëm afatshkurtër 2: Përmirësimi i funksionimit dhe ndërveprimit të jashtëm të agjencisë me aktorët e tjerë sektorialë;

Produkti 2.1 Zhvillimi i komunikimit të jashtëm strategjik;

Produkti 2.2 Forcimi i angazhimit nga ana e Kryeministrit, KKU-së, GIMP-së, Komiteteve Strategjike dhe Komisioneve Ndërkufitare;

Produkti 2.3 Ndërveprim i përmirësuar me njësitë e qeverisë vendore, ZABU-të, komunitetet dhe qytetarët;

Produkti 2.4 Ndërveprim i përmirësuar me përdoruesit e ujit;

Produkti 2.5 Sqarimi i rolit dhe bashkërendimi me komponentin e mjedisit dhe aktorët që ofrojnë kontributin e tyre për rregullimin e burimeve ujore;

Produkti 2.6 Krijimi i sistemit të menaxhimit të riskut ujor (tepricë ose mungesë uji).

Rezultati i pritshëm afatshkurtër 3: Rritje e nivelit të ndërgjegjësimit për përdorim të sigurt, të barabartë dhe të ligjshëm të burimeve ujore

Produkti 3.1 Zbatimi i fushatës për menaxhimin e burimeve ujore;

Produkti 3.2 Zhvillimi i programi që raporton aktivitetet e paligjshme në basenat e lumenjve;

Produkti 3.3 Zhvillimi i një zgjidhjeje digjitale për rritjen e transparencës dhe përfshirjen e qytetarëve në vendimmarrje (mundësisht nëpërmjet një faqeje interneti);

Kohëzgjatja e projektit: 3 vjet, 2019–2021. Buxheti i projektit: 1,910,000 euro që i korrespondojnë 19,676,000 SEK.

1. Hyrja dhe historiku

Forcimi i kapaciteteve lidhet ngushtë dhe ndihmon për të orientuar fuqizimin institucional. Hallkat më të rëndësishme të zinxhirit për menaxhimin e burimeve ujore janë institucionet, organizatat e sektorit të ujit dhe “mjedisi mundësues”. Është e nevojshme të forcohen njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet si të individëve ashtu edhe të organizatës.

Ky dokument paraqet një propozim për të mbështetur në forcimin e kapacitetit institucional të Agjencisë për Menaxhimin e Burimeve Ujore (AMBU), në Shqipëri. Propozimi është përgatitur nga AMBU-ja dhe i është dorëzuar për mbështetje financiare Agjencisë Suedeze për Zhvillim e Bashkëpunim Ndërkombëtar.

1.1 Mbështetje dypalëshe për sektorin e ujit

Qeveria suedeze nëpërmjet SIDA-s ka ndihmuar vazhdimisht Shqipërinë në sektorët e Menaxhimit të Burimeve Natyrore dhe Mjedisit. Qëllimi i kësaj mbështetjeje ka qenë të ndihmohet shteti shqiptar që të zbatojë reformat e nevojshme për të arritur statusin kandidat dhe përfundimisht edhe anëtarësimin në BE. Kjo mbështetje është kanalizuar nëpërmjet komponentëve si më poshtë:

- mbështetje në mirëqeverisjen e sektorit të burimeve ujore duke ngritur një sistem funksional, megjithëse procesi i menaxhimit dhe ofrimi i shërbimeve është një detyrim vetëm i qeverisë shqiptare;

- mbështetje për dokumentet strategjike dhe planifikues, si dhe për ngritjen e sistemit të integruar të informacionit dhe riorganizimit institucional (ngritja e AMBU-së);

- mbështetje në procesin e negociatave në lidhje me kapitullin 27 të BE-së, dhe mbështetje në aspektet rregullatore dhe përafrimin e ligjeve vendëse me legjislacionin e BE-së.

1.1.1 Bashkëpunimi me asistencat e tjera në fushën e sektorit të ujërave

Krahas mbështetjes suedeze, duke mbajtur parasysh se Menaxhimi i Integruar i Ujërave (MIU) është një fushë prioritare, dhe është në përputhje me qasjen NEXUS (ujërat, energjia dhe siguria ushqimore), ekzistojnë një numër projektesh që po zbatohen aktualisht në Shqipëri. Në kuadër të strategjisë së vendit dhe në përputhje me perspektivat kombëtare, MIU-ja po mbështetet nga BE-ja dhe ADA me një projekt të ndarë në katër komponentë:

I. Harmonizimi i legjislacionit të menaxhimit të ujërave me theks të veçantë në direktivën kuadër të ujit

II. Përputhshmëria e elementeve fillestar të DKU-së me Planet për Menaxhimin e Baseneve Ujore

III. Forcimi i kapaciteteve dhe programe të integruara të trajnimit

IV. Krijimi i parimeve të përdorimit të ujit rikuperimi i kostove dhe ndotësi paguan (DKU, neni 5) në nivelin e baseneve ujore, si parakusht/incentiv për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve ujore dhe si një faktor tjetër nxitës në procesin e reformës së sektorit për menaxhimin e ujit në Shqipëri.

Dy synimet kryesore janë, të mundësohet zbatimi i agjendës kombëtare për reformën sektoriale të ujit, si dhe të ndihmohen autoritetet përgjegjëse në zbatimin e kërkesave të direktivës kuadër të ujit (DKU).

Mbështetja nga BE-ja/ADA-ja ka një komponent për “Ngritjen e kapaciteteve dhe program të integruar trajnimi” dhe pikërisht për këtë është i rëndësishëm bashkëpunimi si me AMBU-në dhe me ekipet e tjera që ofrojnë mbështetje. Megjithatë, projekti i BE-së/ADA-së fokusohet në politikat e anëtarësimit në BE, ndërkohë që ky nuk është fokusi i këtij propozimi. Dy propozimet konsiderohen më shumë si plotësuese për t’i dhënë mundësinë AMBU-së të ndërtojë strukturat e menaxhimit të brendshëm (me anë të projektit të mbështetur nga SIDA), të cilat mund të zhvillohen edhe më tej në zbatimin e përditshëm. Kjo përfshihet veçanërisht në komponentët I, II dhe III, ku parashikohet se projekti i mbështetur nga SIDA, për struktura të përmirësuara menaxhimi (përfshirë rolet dhe përgjegjësitë e qarta), sistemet për vendimmarrjen (përfshirë procedura të qarta pune) dhe metodat (p.sh. përfshirja e aktorëve), do të testohen dhe përshtaten sipas nevojës.

Projekti SANE27, nga Agjencia Suedeze për Mbrojtjen e Mjedisit (ASMM), mbështetur nga SIDA, ofron mbështetje të përgjithshme për të ndihmuar Shqipërinë të hapë kapitullin 27 të negociatave me BE-në. Kapitulli 27, krahas elementeve mjedisore, përfshin edhe ujin. Partneri kryesor i SANE27 nuk është specifikisht AMBU-ja, si në rastin e BE/ADA. Aktualisht nuk parashikohet mbivendosje mes SANE27 dhe propozimeve të AMBU-së për ngritjen e kapaciteteve të paraqitura në këtë dokument.

1.2 Konteksti i Shqipërisë dhe sektori i ujit

Mbështetur nga aktivitete donatore, të përshkruara më sipër, janë kryer shumë studime institucionale gjashtë vitet e fundit, përfshirë identifikimin e aktorëve sektorialë, të cilat çuan në prezantimin e mekanizmit për koordinimin sektorial, Grupi për Menaxhimin e Integruar të Politikave të Ujit (GMIP).

Problemi kryesor në menaxhimin e integruar të burimeve ujore, siç vihet në dukje në këto studime, si dhe në Strategjinë Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore (SKMIBU), ka qenë mungesa e një kuadri të duhur institucional. SKMIBU-ja vëren se kuadri institucional është i copëzuar dhe koordinimi është i varfër. Shpesh funksionet mbivendosen, janë të paplota ose të paqarta. Disa prej problemeve kryesore që lidhen me organizimin institucional dhe shpërndarjen e funksioneve, janë:

- nuk ka një tablo të plotë e koherente të situatës së burimeve ujore në vend;
- menaxhimi i burimeve ujore në Shqipëri është pothuajse i centralizuar, ku vendimmarrja kryhet në nivel qendror dhe ka ndryshime të vazhdueshme, të cilat kanë sjellë mbivendosjen e përgjegjësiave ndërmjet institucioneve të pushtetit qendror dhe vendor, çka ka sjellë një sektor të copëzuar, me aktivitete joefikase dhe me mungesë transparence;
- nuk ka ndarje të qartë mes roleve drejtuese (niveli drejtues është dhe një nga hallkat më të dobëta të sistemit) dhe roleve operacionale. Sistemi i monitorimit, i cili është mekanizmi i vetëm për të verifikuar/konfirmuar rezultatet e politikave dhe investimeve, mbetet një nga shqetësimet kryesore për gjithë sistemin;
- niveli drejtues është tepër i brishtë dhe në kuadër të decentralizimit nuk mund të plotësojë vakumin midis aktiviteteve të qeverisë qendrore dhe vendore, duke e mbajtur kështu të ndarë politikëbërjen nga zbatimi i politikave;

- institucionet e përfshira në menaxhimin e ujit janë shumë të copëzuara, pasi secila ministri është përgjegjëse për disa sektorë ose seksione. Aktorët institucionalë janë të paqartë për çfarë janë përgjegjës, për më tepër, për shumicën e aktorëve, rregullimi i sektorit të ujit është një koncept shumë i paqartë (ky problem rëndohet nga mungesa e kulturës së bashkëpunimit të institucioneve);

- ka mospërputhje mes kufijve hidrologjikë të 6 baseneve dhe kufijve administrativë të rretheve apo njësive vendore dhe kjo sjell mbivendosje/kontradikta mes funksioneve drejtuese;

- një nga problemet kryesore është “bashkëpunimi ndërmjet aktorëve”. Për shumicën e aktorëve nuk ka qartësi mes “Kush bën/supozohet të bëjë çfarë”. Matrica e bashkëpunimit tregon se shumë nisma për bashkëpunim shpesh rezultojnë në sfida të vërteta;

- mungon bashkërendimi institucional, dhe si rezultat ka mbivendosje, përsëritje të punës dhe konsum energjie apo në raste të tjera mungesa funksionale. Shpesh, ka kontradikta mes kompetencave, duke mos respektuar ndarjen hierarkike të roleve dhe përgjegjësi, qoftë si pasojë e kuadrit ligjor. Ky copëzim ka çuar edhe në mungesë përgjegjshmërie, si dhe zbatim të varfër të politikave apo dokumenteve strategjikë. Vërehen mangësi të mëdha në prodhimin dhe përdorimin e informacionit/të dhënave/njohurive që lidhen me elementet e cilësisë së burimeve ujore dhe sistemin e inspektimit dhe kontrollit. Si pasojë, shpërndarja e detyrave në shumë institucione ka sjellë rezultate të dobëta dhe pamundësi “për të drejtuar gishtin” tek institucioni përgjegjës;

- ka një sërë institucionesh që janë të përfshira në monitorimin e burimeve ujore, duke shkaktuar kështu paqartësi dhe shpesh edhe mbivendosje (Ministria e Mjedisit dhe Turizmit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, Instituti i Gjeografisë, Ujit dhe Mjedisit);

- ka mospërputhje (konflikt interesash) në shpërndarjen e funksioneve (shembull: para se të ndryshohej ligji nr. 111/2012, MARD-i ishte dhe përdoruesi kryesor i ujit, si dhe ndotësi kryesor, por ishte përgjegjës edhe për menaxhimin e burimeve ujore);

- varësi joefektive/të papërshtatshme të organizimit të institucioneve (shembull: IGJEUM raporton ose është në varësi të Universitetit Politeknik të Tiranës);

- organizim territorial joefektiv dhe joefikas (shembull: drejtoritë e ujitjes dhe kullimit funksionojnë në qarqe dhe janë përgjegjëse për të administruar ujitjen dhe përmytjen që sipas tyre duhet të organizohet në nivel baseni);

- në qeverinë vendore mungojnë strukturat profesionale për përmbushjen e funksioneve të decentralizuara. Për një periudhë kohe do të jenë strukturat e qeverisë qendrore ato që duhet të plotësojnë këtë mangësi (shembull: mungesa e strukturave në qeverinë vendore për çështje që lidhen me sigurinë e digave, ose ujitjen dhe kullimin);

- është shumë i dobët bashkëpunimi mes qeverisë qendrore dhe vendore, duke sjellë vështirësi në përkthimin e politikave, të përgatitura nga ministratë e linjës, në masa konkrete;

- në shumicën e rasteve, organizimi i brendshëm dhe mënyra e strukturimit, dija teknike institucionale, kapacitetet e burimeve njerëzore dhe ekspertiza dhe infrastruktura ekzistuese e institucioneve të përfshira në menaxhimin e burimeve ujore nuk i përgjigjen sfidave të tyre dhe detyrave që priten prej tyre;

- meqë menaxhimi i ujërave është një nga aspektet më komplekse për fillimin e procesit të negociatave me Bashkimin Evropian, mekanizmi ekzistues institucional krijon paqartësi rreth kësaj përgjegjësie (shembull: Mbivendosje strukturash në procesin aktual të raportimit).

Si rezultat i këtij problemi, është propozuar centralizimi/përqendrimi i funksioneve, të shpërndara në institucione të ndryshme, në një institucion të vetëm, përgjegjës për menaxhimin e integruar të ujërave, i cili nëpërmjet degëve të zyrës e shtrin veprimtarinë në nivel baseni ujor.

Pas riorganizimit të qeverisë shqiptare, pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 2017, sektori i menaxhimit të ujërave kaloi nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në vartësinë e Kryeministrit. Siç edhe përmendet më sipër, bazuar në portofolat ministrorë dhe propozimet e

strategjive, është kryer një ristrukturim me nëpërmjet krijimit të Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore. Në zbatim të këtij propozimi, u ndryshua edhe ligji “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore” i cili solli dhe krijimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, si një institucion qendror përgjegjës për menaxhimin e integruar të burimeve ujore, falë zhvillimit dhe zbatimit të politikave.

Shkurtimisht më poshtë janë përshkruar ndryshimet kryesore që kanë ndodhur deri tani në organizimin institucional, përgjegjës për menaxhimin e integruar të burimeve ujore, pas reformës qeveritare dhe strukturore të vitit 2017:

1. Përgjegjësia e menaxhimit të burimeve ujore kaloi nga MBZHR-ja nën përgjegjësinë e Kryeministrit, si rrjedhojë edhe Drejtoria e Politikave Ujore (më parë në varësi të MBZHR-së) iu atashua AMBU-së, e cila është tanimë përgjegjëse për zhvillimin e politikave.

2. Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar Ujor (TSKKU) është rivendosur nën Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU-ja), e cila krahas detyrave të tjera, do të vazhdojë të përmbushë detyrimet e sekretariatit teknik të KKKU-së.

3. Agjencitë e baseneve të lumenjve janë shndërruar në zyrat e administrimit të basenit ujor (ZABU) dhe numri i tyre u ul nga gjashtë në katër. Është rishikuar edhe organizimi, funksionet dhe struktura e tyre.

4. Inspektorati Shtetëror i Ujërave (ISHU) është shkrië me Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve (ISHMP) duke krijuar kështu Inspektoratin Shtetëror për Mjedisin, Pyjet dhe Ujërat (ISHMPU).

1.3 Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU)

1.3.1 Ristrukturimi i AMBU-së

Pas riorganizimit të qeverisë, pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 2017, siç përmendet dhe më sipër, sektori për menaxhimin e ujërave kaloi nga përgjegjësia e Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në përgjegjësinë e Kryeministrit.

AMBU-ja ka në përgjegjësinë e saj zyrat e administrimit të baseneve ujore (ZABU), të cilat janë organizuar dhe funksionojnë sipas baseneve ujore, në përputhje me dispozitat ligjore të ligjit nr. 6/2018 “Mbi disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 111/2012, ‘Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore’” dhe akteve nënligjore që dalin në zbatim të tij.


AMBU-ja, si institucioni kryesor (institucioni mëmë) i cili përmbush qëllimet dhe vizionin për menaxhimin e integruar të burimeve ujore, siç përcaktohet në programin politik të qeverisë, është krijuar me VKM-në nr. 221, datë 26.4.2018, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore”. Pas aprovimit të VKM-së, u përgatit organizimi i brendshëm (organigrama + lista e personelit) dhe u miratua me urdhër të Kryeministrit. Krijimi i agjencisë së re përfundoi me aprovimin e organizimit të brendshëm nga Kryeministri dhe AMBU-ja është një subjekt ligjor që ka personalitetin e tij juridik.

Edhe pse është përfunduar gjithçka në letër, në realitet, ky institucion i ri, AMBU-ja, po ballafaqohet me një numër sfidash dhe vështirësish, dhe aktualisht po përpaket të krijojë strukturën e brendshme organizative dhe të fillojë ekzekutimin e funksioneve të reja ligjore duke:

- krijuar funksionet që duhen ekzekutuar për të përmbushur qëllimin;
- qartësuar përgjegjësitë dhe rolin e saj në këtë sektor, për të shmangur mbivendosjet me institucionet e tjera;
- emëruar stafin në vendet përkatëse të punës;
- blerjen dhe përmirësimin e teknologjisë dhe aseteve;
- testuar, akomoduar dhe vendosur në funksion struktura të reja të brendshme;
- garantuar ndërveprimin dhe koordinimin e duhur me aktorët e jashtëm (institucione të tjera që kanë përgjegjësi për burimet ujore).


Modeli më poshtë tregon organizimin institucional, ku në të djathtë ndodhen organet vendim-marrëse dhe në të majtë, organet administrative. AMBU-ja i raporton Këshillit Kombëtar të Ujit

dhe zyrat e administrimit të baseneve ujore i raportojnë këshillave të baseneve ujore, por funksionojnë në varësi të AMBU-së.



Zyra qendrore e AMBU-së, është Drejtoria e Përgjithshme, e vendosur në Tiranë, e cila përbëhet nga Drejtoria e Menaxhimit Strategjik, Drejtoria e Menaxhimit të Performancës, Drejtoria për Menaxhimin e Burimeve Ujore dhe Drejtoria për Financën dhe Shërbimet Mbështetëse. DP-ja është parashikuar që të ketë një numër personeli prej 42 personash dhe drejtuesish (afërsisht janë plotësuar 21 pozicione deri tani, 12 femra dhe 9 meshkuj).

Zyrat për administrimin e baseneve ujore (ZABU), që njiheshin dikur si agjencitë e baseneve ujore, përbëhen nga Inventari i Burimeve Ujore dhe Sektori i Informimit dhe Sektori i Lejeve dhe Monitorimit – Kontrollit. Dikur ABU-të ishin 6 dhe tani janë 4 zyra, pasi u shkrinë zyrat administrative, Ishëm–Erzeni me zyrën e Matit dhe Zyra Administrative e Shkumbinit me atë të Semanit. ZABU-të do të zgjerohen me numër personeli prej 40 personash dhe drejtuesish (afërsisht 23 janë punësuar deri më sot, 9 femra dhe 14 meshkuj).



Skema më lart, paraqet organigramën e AMBU-së në nivel drejtorie (grafiku bazë). Aktualisht stafi ekzistues i AMBU-së është pasqyruar në organigramën e re.

Bazuar në legjislacionin për nëpunësit civil, për plotësimin e vendeve vakante do të shqyrtohet fillimisht mundësia e rritjes në detyrë të personelit ekzistues, më pas procesi vijon me transferime paralele. Në rastet kur, edhe pasi është ezauruar ky hap, vendet mbeten vakante atëherë Departamenti i Administratës Publike shpall procesin e rekrutimit të burimeve njerëzore jashtë shërbimit civil.

AMBU-ja ka përcaktuar kriteret për secilin nga pozicionet dhe ka përgatitur përshkrimin bazë të punës, ndërsa përshkrimi më i detajuar i punës për secilin nga pozicionet është nga produktet që propozohet të realizohet, në këtë dokument.

1.3.2 Qëllimi dhe misioni i AMBU-së

Qëllimi strategjik i AMBU-së, mbështetur nga SIDA, ka çuar në përkufizimin e mëposhtëm të qëllimit, misionit dhe vizionit, si dhe parimeve kryesore të AMBU-së:

Qëllimi i AMBU-së është të mbrojë dhe të përmirësojë burimet ujore, si dhe përdorimin e tyre të arsyeshëm dhe të qëndrueshëm, duke kontribuar në këtë formë në mirëqenien e qytetarëve dhe zhvillimin e vendit.

Misioni i AMBU-së është mirëqeverisja e burimeve ujore për të përmbushur të gjitha nevojat jetike për ujë, dhe duke garantuar njëkohësisht qëndrueshmërinë e ekosistemeve, promovimin e konkurrencës dhe priorizimin e përfitimeve ekonomike.

Vizioni i AMBU-së përkufizohet nga një numër dokumentesh strategjike që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë lidhen me menaxhimin e integruar të burimeve ujore. Vizioni për burimet ujore përkufizohet në SKMIBU 2018–2027 ku thuhet: “Shqipëria, një vend që përdor ujin në mënyrë efikase, nëpërmjet menaxhimit të integruar dhe funksional të burimeve ujore, përfshirë monitorimin e plotë dhe sistemin e menaxhimit të risqeve nga përmbytjet dhe mungesat/pamjaftueshmëritë ujore, në përputhje me standardet dhe praktikën më të mira evropiane. Një vend që organizon përdorimin e burimeve ujore mbi parimet e barazisë dhe qëndrueshmërisë për përfitime ekonomike të barabarta sociale dhe gjinore, si dhe për drejtësi mjedisore për brezat e sotshëm dhe të ardhshëm.”.

Veprimtaria e AMBU-së udhëhiqet nga këto parime:

- Drejtësia: për përfitimet, përgjegjësitë, nevojat dhe mundësitë;
- Integriteti: i elementeve qeverisëse kundrejt funksioneve dhe qëllimit;
- Baraspesha: Garantimi i një statusi optimal ndërmjet përdorimit, kohës, vlerës dhe cilësisë;
- Kohëzgjatja: raporti kosto-përfitim i shpërndarë në kohë dhe për brezat e ardhshëm.

AMBU-ja është themeluar dhe funksionon bazuar në këto vlera:

- Jeta: Uji si burim energjie që nuk zhvlerësohet, por rinovohet me kalimin e kohës;
- Natyra: Kushte të favorshme klimatike, burimet ujore dhe shumëllojshmëri e specieve;
- Territoriale: zona të konsiderueshme me ujëra nëntokësore dhe ujëra sipërfaqësore në dispozicion;

- Tradita: Shqipëria ka një traditë institucionesh që i janë kushtuar burimeve ujore, institucione akademike dhe profesionistë me përvojë në fushën e kërkimeve shkencore dhe menaxhimit të burimeve ujore që mund të kontribuojnë në përmirësimin e sektorit.

1.3.3 Përgjegjësitë e AMBU-së

Brenda fushës së përgjegjësisë së saj, AMBU-ja përmbush funksionin në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 221, datë 26.4.2018. Funksionet kryesore janë:

i. Zhvillimi, rregullimi dhe financimi i sektorit: projektstrategjitë, planet, programet dhe projektet për zhvillimin e sektorit dhe menaxhimin e integruar të burimeve ujore janë në zbatim të tij; identifikon, vlerëson, harton dhe propozon akte ligjore që lidhen me menaxhimin e burimeve ujore dhe ndjek aprovimin e tyre në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse; kryen procesin e optimizimit të përdorimit të burimeve ujore përkundrejt përfitimit ekonomik, në

përputhje me parimet, prioritetet dhe nevojat e vendit për përdorim, si dhe kriteret për konservimin dhe ruajtjen sasiore dhe cilësore të burimeve ujore dhe garanton menaxhimin e integruar të burimeve ujore.

ii. Funksionet drejtuese: fokusohen në sistemin e burimeve ujore, janë përgjegjës për materializimin dhe funksionimin e sistemit. Drejton punën për të garantuar efikasitetin dhe efektivitetin e përdorimit të burimeve ujore, funksionimin dhe ndërveprimin e sistemit, bashkëpunimin ndërmjet aktorëve, përdorimin e qëndrueshëm dhe prioritizimin e përdorimit të ujit. Gjithashtu, vlerëson zbatueshmërinë/fizibilitetin e përdorimit, garanton qeverisje të integruar, krijon dhe menaxhon sistemit e informacionit, harton norma dhe standarde dhe orienton aktorët drejt një vizioni të përbashkët. Ky funksion garanton performancën dhe efikasitetin e sistemit, organizon/formulon strukturat në përputhje me aktivitetet, strategjitë dhe realitetin (mjedisin), përkufizon dhe zbaton treguesit për vlerësimin e performancës dhe skemat. Ky nivel është përgjegjës edhe për marrëdhëniet ndërinstytucionale duke garantuar angazhimin e gjithë aktorëve.

iii. Funksionet menaxhuese: fokusohen në ofrimin e produktit/shërbimit. Planifikon, zbaton dhe kontrollon punën, si dhe garanton se produktet ose shërbimet janë cilësore, të buxhetuara dhe të zbatuara në kohë. Integron përgjegjësitë për të nxjerrë një produkt të shkëlqyer, të qëndrueshëm dhe të sigurt. Ka rolin edhe të analizojë proceset, të vlerësojë devijimet/mangësitë në lidhje me përmbushjen e objektivave, hartimin e standardeve dhe planeve menaxheriale, menaxhon ndryshimet e nevojshme në program dhe në burimet ekzistuese.

iv. Funksionet operacionalë: fokusohen në administrimin dhe operimin e burimeve ujore, përfshirë përmbushjen e detyrave që lidhen me grumbullimin dhe strukturimin e informacionit, administrimin e lejeve dhe autorizimeve, monitorimin e përputhshmërisë së lejeve dhe autorizimeve me kriteret, promovimin e burimeve ujore dhe përdorimin e tyre të qëndrueshëm, menaxhimin dhe dokumentimin e mbledhjeve të KKU-së dhe KBU-së, si dhe mbështetje në veprimtarinë e institucionit.

1.3.4 Ndërveprimi i AMBU-së me aktorët

Ndërveprimi vertikal

Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore është një institucion në varësi të Kryeministrit. Siç përmendet më lart, nga pikëpamja e funksionimit administrativ, AMBU-ja ka varësi funksionale, komunikon dhe koordinon veprimtarinë e saj me drejtoritë përkatëse në Kryeministri. Nëpërmjet kësaj varësie, AMBU-ja është pjesë e sistemit të Kryeministrit, dhe si e tillë nuk mund të konsiderohet një sistem/institucion i izoluar apo i pavarur nga pjesa tjetër e qeverisë. AMBU-ja është pjesë e reformave të vazhdueshme që ndërmerr qeveria.

Në të njëjtën kohë, AMBU-ja ka në varësinë e saj zyrat administrative të baseneve ujore (ZABU), nëpërmjet të cilave shtrin veprimtarinë e saj në gjithë territorin. ZABU-të janë organizuar dhe funksionojnë sipas baseneve, në përputhje me dhe në zbatimin të ligjit dhe VKM-ve që përcaktojnë numrin dhe shtrirjen e tyre gjeografike.

Në përmbushje të aktivitetit të saj, AMBU-ja bashkëpunon, bashkërendon dhe mbështet institucionet apo agjencitë e tjera nën varësinë e Kryeministrit (si Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor – ASIG për sistemin gjeohapësinor të burimeve ujore ose të kadastrës ujore, Agjencinë Kombëtare të Planifikimit Territorial – AKPT-në për probleme që lindin nga planifikimi territorial dhe Agjencinë për Zhvillim Territorial – AZT-në për rishikimin dhe lëshimin e lejeve).

Ndërveprimi horizontal

Ndërveprimi institucional: Për të përmbushur misionin dhe funksionet sipas ligjit dhe VKM-së përkatëse, AMBU-ja ka të drejtë të kërkojë dhe të marrë informacion, mbështetje dhe çdo ndihmë tjetër të nevojshme, nga institucionet shtetërore, qendrore dhe vendore. Institucionet shtetërore kanë përgjegjësinë t'i përgjigjen kërkesave të AMBU-së, të shkëmbejnë të dhëna, të ofrojnë mbështetje të plotë dhe të krijojnë lehtësirat e nevojshme për të përmbushur funksionet.

Në kontekstin e përmirësimit të performancës së institucioneve, optimizimit të burimeve në mënyrë që institucionet të fokusohen në detyrat kryesore që mbulon fusha e tyre e përgjegjësisë, një nga mundësitë që mund të merret në konsideratë është që numri i funksioneve (kryesisht mbështetëse) të mos kryhet nga vetë AMBU-ja, por t'i delegohet institucioneve të tjera në varësinë e Kryeministrit të specializuar në kryerjen e këtyre funksioneve (meqë AMBU-ja është pjesë e sistemit të Kryeministrit). Më poshtë janë disa shembuj të këtij bashkëpunimi:

- Për krijimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të informacionit gjeohapësinor (Kadastra e Burimeve Ujore), për sistemin e lejeve *on-line* etj. AMBU-ja bashkëpunon dhe mbështetet nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) dhe Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG), institucione të specializuara në fushën e informacionit dhe gjeoinformacionit.

- Në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike (DAP) mundëson modelin e duhur organizativ dhe me anë të ciklit për plotësimin e vendeve vakante, zgjedh burimet njerëzore që kanë aftësitë e duhura, përfshirë rekrutimin, vlerësimin, angazhimin, trajnimin, zgjidhjen e marrëdhënies së punës, krijimin dhe përditësimin e bazës së të dhënave për burimet njerëzore.

- Në bashkëpunim me inspektoratet (Inspektoratin Qendror, Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave, Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes Territoriale) kryen inspektime të lejeve dhe autorizon përdorimin e ujit në përputhje me standardet, proceset dhe bazat e të dhënave, lejeve mjedisore, sigurisë dhe mbrojtjes së organeve ujore nga ndotësit e mundshëm etj.

Duhet përmendur se AMBU-ja është ajo që vendos të marrë në konsideratë mundësitë për bashkëpunim dhe të negociojë marrëveshjet me institucionet përkatëse, bazuar në vlerësimet dhe nevojat e saj. Për çdo rast, mungesa e kësaj marrëveshjeje nuk pengon/zhvesh institucionet nga detyrimi për t'i ofruar mbështetjen e nevojshme AMBU-së, bazuar në detyrimet ligjore.

Ndërveprimi me donatorët dhe organizatat ndërkombëtare: AMBU-ja bashkëpunon me organizatat ndërkombëtare dhe rajonale, si dhe me agjencitë apo institucionet partnere të vendeve të tjera, fusha e veprimit të cilëve përfshin ruajtjen, promovimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve ujore. AMBU-ja promovon, lehtëson dhe mbështet bashkëpunimin ndërkombëtar të autoriteteve të përfshira në sektorin e burimeve ujore. Përfaqëson Shqipërinë në organizata ndërkombëtare, forume, panele dhe aktivitete të tjera që i kushtohen menaxhimit të integruar të burimeve ujore.

Ndërveprimi me palët e treta: AMBU-ja bashkëpunon me institucionet, bizneset, organizatat vendëse dhe të huaja, grupe të ndryshme interesi, shoqërinë civile dhe me median për të informuar publikun, për të promovuar dhe për rritur ndërgjegjësimin publik mbi rëndësinë strategjike, nevojën për përdorim të qëndrueshëm, ruajtjen, rehabilitimin dhe përmirësimin e burimeve ujore.

1.3.5 Nevoja të mëtijshme për zhvillimin e proceseve të punës

Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore është një institucion i ri të cilit i janë shtuar funksionet dhe luan rol të rëndësishëm në sektor, por ka nevojë për asistencë që të fillojë të funksionojë dhe të sinkronizojë punën me aktorët e tjerë sektorialë, si brenda dhe jashtë institucionit. Duke mbajtur parasysh statusin aktual të AMBU-së dhe projektet në vazhdimësi në këtë sektor, për t'i ofruar ndihmë të rëndësishme për funksionimin dhe rritjen e Agjencisë, duke përdorur sa më mirë asistencën e qeverisë suedeze, si dhe duke shmangur kontradiktat dhe mbivendosjet me projekte të tjera paralele, pas konsultimeve të gjera me aktorët e tjerë, propozojmë të punohet në drejtim të tre rezultateve:

1. Përmirësimi i funksionimit të brendshëm të AMBU-së, ndërmjet drejtorive, sektorëve dhe pozicioneve të caktuara të punës, duke plotësuar organizimin e brendshëm, përmirësimin e komunikimit, vendimmarrjes, informacionit, proceseve të punës, ofrimin e infrastrukturës së nevojshme etj., për të rritur efektivitetin, efikasitetin dhe performancën e AMBU-së.

2. Përmirësimi i ndërveprimit të jashtëm të agjencisë me aktorët e tjerë sektorialë për të përmirësuar dhe për të pozicionuar si duhet AMBU-në në këtë sektor, duke i dhënë vlerë punës së saj dhe për të përmirësuar performancën e sektorit të burimeve ujore, duke kontribuar në mirëmenaxhimin e këtyre burimeve dhe në mirëqenien e qytetarëve.

3. Nivele të rritura ndërgjegjësimi për përdorim të sigurt, të barabartë dhe të ligjshëm të burimeve ujore, duke rritur ndërgjegjësimin mbi burimet ujore, dhe me anë të fushatave që synojnë grupe të ndryshme, duke krijuar mekanizma që identifikojnë, raportojnë dhe hetojnë aktivitetet e paligjshme në basenet e lumenjve dhe duke rritur transparencën, si dhe përfshirjen/angazhimin e qytetarëve.

Këto tre rezultate janë pasqyruar në TN dhe në Kornizën e Rezultateve, ku secila ka një set produktesh dhe indikatorësh të pritsëm.

1.4 Elemente kyç joteknike për t'u marrë në konsideratë

1.4.1 Elementet mjedisore, sociale/gjinore dhe të drejtat në investimet ujore

Nevoja për investime në sektorin e ujit në Shqipëri është shumë e madhe; nevojiten financime e hua të jashtme për të përmbushur prioritetet kryesore kombëtare për menaxhimin e burimeve ujore, si dhe anëtarësimin në BE. Investitorët e mundshëm në sektorin e ujit, kanë një numër kërkesash mjedisore dhe sociale për investime, si: Banka Botërore, Banka Evropiane për Rindërtim e Zhvillim, BE-ja dhe donatorët dypalësh. Kërkesat mund të dallojnë pak nga njëra-tjetra, por në përgjithësi përfshijnë aspekte që shkojnë përtej investimeve dhe vendosin detyrime tek organizatat kryesore dhe te biznesi i klientëve të tyre:

- planifikimi mjedisor dhe social si pjesë e biznesit bazë të klientëve;
- kushtet e punës, si menaxhimi i burimeve njerëzore, përfshirë aspektet si shanset e barabarta, antidiskriminimi, mosngacmimet, përfshirë ngacmimin seksual, shëndetin dhe sigurinë në punë, moslejimin e punësimit të fëmijëve dhe punën e detyruar;
- ndotja, parandalimi dhe ulja e saj;
- shëndeti dhe siguria e komunitetit;
- ruajtja e biodiversitetit;
- detyrime më të rrepta të parashikuara në legjislacionin vendës, për përvetësim prone, e cila përfshin edhe zhvendosjen dhe risistemimin ekonomik;
- mbrojtjen e trashëgimisë kulturore;
- angazhim dhe komunikim me aktorët.

AMBU-ja ose ZABU-të, aktualisht nuk kanë staf që të ketë njohuri mbi aspektet dhe kërkesat e sipërpërmendura, dhe AMBU-ja aktualisht nuk ka as strukturën dhe personelin e duhur për të siguruar integritimin e duhur të këtyre aspekteve sociale dhe mjedisore. Ky propozim është një hap i parë në përpjekjen për të rritur ndërgjegjësimin lidhur me këto nevoja.

1.4.2 Ndryshimi i mjedisit/klimës dhe uji

Objektivat mjedisorë janë tema qendrore e direktivës kuadër të ujit (2000/60/EC), dokument ligjor që rregullon menaxhimin në planin afatgjatë dhe të qëndrueshëm të burimeve ujore në shtetet anëtare të BE-së. Cilësia e ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësore duhet ruajtur dhe duhet të mbahen standardet e cilësisë mjedisore që ka caktuar BE-ja. Uji për mjedisin, është një nga katër shtyllat e përdorimit të ujit që parashikohen në Strategjinë Kombëtare MIBU, dhe duhen alokuar sasi të mjaftueshme për të garantuar fluksin mjedisor dhe kërkesa të tjera mjedisore për ujë.

Ndryshimet klimatike kanë sjellë vështirësi si në cilësinë ashtu edhe në sasinë e ujit. Temperaturat e larta sjellin ndryshime në cilësinë e ujit dhe reduktimin e sasisë së ujit në ekosistemet ujore dhe mund të shkaktojnë probleme të rënda sezonale në cilësinë e ujit deri në mungesë të tij. Në një plan afatgjatë, ndryshimet klimatike do të sjellin ndryshime në sasinë e reshjeve dhe në ciklin qarkullues të ujit (rrjedha e ujit) çka rrit degradimin e tokës dhe erozionin, si dhe rrit rrezikun nga përmytjet.

1.4.3 Barazia gjinore dhe uji

Angazhimet ndërkombëtare ligjore

Shqipëria u bë shtet palë e Konventës për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (KEFDG) pas anëtarësimit më 11 maj 1994. KEFDG-ja parashikon, ndër të drejta të tjera, paga të barabarta për të njëjtën punë dhe mundësi të barabarta punësimi (neni 11), barazi në pozicione dhe akses në vendimmarrje private dhe publike (neni 7). KEFDG-ja, gjithashtu, parashikon se shtetet palë duhet të marrin masa të veçanta për të rritur barazinë gjinore (neni 4).

Angazhimi i BE-së

E ashtuquajtura direktivë e ndryshuar (2006/54/EC) mbi shanset e barabarta dhe trajtimin e barabartë të burrave dhe grave në punësim dhe profesione, ka bashkuar disa nga direktivat më të vjetra. Kjo direktivë kërkon ndalimin e diskriminimit seksual, të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, ngacmimin dhe ngacmimin seksual, (akses në) punësim dhe skemën e sigurimeve shoqërore. Sipas nenit 3(2) Traktati i Amsterdamt 1999 KE, Komuniteti synon të eliminojë pabarazitë dhe të nxisë barazinë mes burrave dhe grave. Ky detyrim i rregullimit gjinor nënkupton se, si Komuniteti dhe shtetet anëtare, duhet të marrin parasysh në mënyrë aktive objektivin për barazi gjinore mes burrave dhe grave kur të formulojnë dhe të zbatojnë ligjet, rregulloret, dispozitat administrative, politikat dhe aktivitetet.

Legjislacioni vendës

Ligji për barazinë gjinore (2008) parashikon që rregullimi gjinor është qasja për të garantuar barazi gjinore në shoqëri, duke përfshirë të gjitha gjinitë në ligjbërje, politikëbërje, planifikim, procese zbatimi dhe monitorimi. Ligji mbulon edhe diskriminimin e ngacmimin, si dhe parashikon masa të posaçme, të përkohshme, për të garantuar të paktën 30% përfaqësim nga gjinia më pak e përfaqësuar në politikë, pozicione drejtuese publike dhe në administratë. Për më tepër, ligji për barazinë gjinore e bën detyrueshëm gjenerimin e statistikave me baza gjinore nga organet shtetërore.

Statistikat gjinore që kanë rëndësi në sektorin e ujit

Në vitin 2017, Indeksi Botëror për Hendekun Gjinor, e renditi Shqipërinë në vendin e 38 nga 144 vende (mesatarja është rritur për shkak të pikëve në pjesëmarrjen në arsim dhe në politikë, e renditur në vendin e 70 për pjesëmarrje ekonomike dhe mundësi, dhe në vendin e 120 në shëndetësi. Pjesëmarrja në forcën e punës është 47.5% për gratë dhe 70.4% për burrat dhe vlerësohet se gratë fitojnë 53% të asaj që fitojnë burrat. Hartuesit e legjislacionit, zyrtarët e lartë dhe drejtuesit përbëhen nga 22,5% gra dhe 77,5% burra. Këto shifra të përgjithshme për Shqipërinë përkthehen po njësoj edhe në sektorin e ujit, ku ka një nënpërfaqësim në pozicionet drejtuese¹ që lidhen me menaxhimin e burimeve ujore. Gjashtë Basenet e mëparshme të lumenjve kishin më shumë meshkuj në role drejtuese, po ashtu edhe specialistë në agjencitë e baseneve ujore dhe shumë pak gra në këshillat e baseneve ujore. Në vitin 2016, ekipi i hartimit të Strategjisë MIBU arriti në përfundimin se:

- Në Mat, thuajse të gjitha aktivitetet ekonomike në basene janë të dominuara nga meshkujt. Në Këshillin e Basenit të Lumenjve, gratë nuk janë të përfaqësuara dhe si të tilla nuk përfshihen as në proceset vendimmarrëse për lëshimin e lejeve për përdorimin e burimeve ujore. Në Agjencinë e Basenit të Lumenjve, vetëm 20% e personelit ishin gra (që nuk është në përputhje me ligjin nr. 9970).

- Në Agjencinë e Basenit të Lumenjve Ishëm-Erzen, përfaqësimi nga femrat ishte 7.7%, ndërsa 37.5% e punonjësve të Autoritetit të Basenit të Lumenjve ishin femra (pjesërisht në përputhje me ligjin nr. 9970).

- Në Shkumbin nuk kishte asnjë femër anëtare të Këshillit të Basenit të Lumenjve dhe vetëm 20% e personelit të Agjencisë së Basenit të Lumenjve ishin femra (jo në përputhje me ligjin nr. 9970).

¹ Megjithëse, ligji nr. 9970/2007, "Për barazinë gjinore në shoqëri" parashikon se 30% e vendeve në parlament në zgjedhjet parlamentare, si dhe në institucionet vendimmarrëse duhet të jenë përfaqësues nga gratë.

- Në Seman, asnjë femër nuk ishte anëtare e Këshillit të Basenit të Lumenjve dhe vetëm një femër ishte punësuar në Agjencinë e Basenit të Lumenjve (jo në përputhje me ligjin nr. 9970).

Në Vjosë femrat përbënin 16.6% të anëtarëve të këshillit. Agjencia e Basenit të Lumenjve ka 40% të punonjësve femra (pjesërisht në përputhje me ligjin nr. 9970).

U krye ristrukturimi dhe po vazhdon plotësimi me personel në AMBU dhe për katër strukturat e reja të baseneve të lumenjve, dhe tani është mundësia për të qenë konform legjislacionit vendës. Si rrjedhojë, ky propozim do të synojë të forcojë pozicionimin e femrave në AMBU dhe në zyrat administrative të baseneve të lumenjve, duke mundësuar përshkrim të qartë detyrash dhe politika të qarta punësimi, për mbajtjen dhe rritjen në detyrë të personelit bazuar në performancën dhe kompetencat e tyre.

2. Projektpropozimi

2.1 Sfidat për t'u trajtuar

Projektpropozimi, me anë të këtij dokumenti synon të trajtojë një numër problemesh ekzistuese dhe vështirësish që ballafaqon sektori i menaxhimit të ujit. Këto vështirësi janë identifikuar nga analizat e kryera gjatë përgatitjes së një sërë dokumentesh sektoriale. Më poshtë gjendet një listë jopërfundimtare me sfidat dhe problemet që pritet të trajtohen/kapërcehen falë zbatimit të këtij projekti.

Rritja e efektivitetit në rregullimin e fushës së ujërave

- Alokimi dhe ndarja e qartë e roleve dhe përgjegjësi për çdo nivel të qeverisjes; drejtues/administrativ, drejtues, menaxherial dhe operacional në sektorin e ujit, si dhe përmirësimi i koordinimit ndërmjet autoriteteve përgjegjëse.

- “Qeverisja e vogël” e ujërave.

- Menaxhimi i burimeve ujore në nivel baseni duke mundësuar një proces vendimmarrës gjithëpërfshirës të politikave kombëtare, përfshirë institucionet e qeverisjes vendore, përdoruesit e ujit, aktorët dhe shoqërinë civile.

- Inkurajimi i politikave koherente nëpërmjet një koordinimi ndërsektorial efektiv, sidomos për politikat që lidhen me ujin dhe mjedisin, sistemin shëndetësor, bujqësinë, industrinë, planifikimin urban dhe përdorim e tokës.

- Përshtatja e autoriteteve përgjegjëse me kulturën e ndërlikuar të sfidave sektoriale dhe me numrin e kompetencave që duhet të zbatohen për të realizuar detyrat e tyre.

Rritja e efikasitetit në rregullimin e sektorit të ujit

- Organizimi funksional i sektorit të ujit duke shmangur copëzimin institucional dhe funksional, mbivendosjet apo keqvendosjet e funksioneve, replikimin e energjive, kohës dhe kostove.

- Rritja e bashkëveprimit dhe krijimi i mekanizmave të duhur të integritetit dhe koordinimit.

- Përmirësimi dhe optimizimi i aktiviteteve dhe veprimtarive që lidhen me burimet ujore dhe lehtësimin e procedurave për shërbimet që i ofrohen përdoruesve të ujit.

- Rregullat dhe procedurat për gjenerimin/grumbullimin, përditësimin dhe shkëmbimin e të dhënave të sektorit të ujit, të krahasueshme, të njëtrajtshme dhe në kohë reale, informacionin e politikave dhe përdorimin e tyre për të menaxhuar, vlerësuar dhe për të përmirësuar politikat ujore.

- Garantimi i një kornize qeverisëse që ndihmon për përdorimin e mbështetjes financiare në sektorin e ujit dhe alokimin e burimeve financiare në mënyrë efikase dhe transparente nëpërmjet aplikimit të dispozitave stimuluese.

- Garantimi se kuadri rregullator në menaxhimin e burimeve ujore do të zbatohet efektivisht dhe do të përmirësohet në interes të publikut të gjerë.

- Promovimi dhe zbatimi i praktikave më të mira që lidhen me metodat inovative për qeverisjen e sektorit të ujit nga institucionet përgjegjëse, nivelet e ndryshme qeverisëse dhe aktorët e ndryshëm.

Rritja e besueshmërisë dhe angazhimit në qeverisjen e fushës së ujërave

- Integrimi i praktikave dhe transparencës ndërmjet politikave të sektorit të ujit, institucioneve që kanë lidhje me ujërat dhe kuadrit për rregullimin e fushës së ujërave për të garantuar përgjegjshmëri më të lartë dhe besueshmëri në proceset vendimmarrëse;

- Promovimi i informimit dhe angazhimit të aktorëve për të rritur kontributin e tyre në përgatitjen e politikave ujore dhe zbatimin e tyre;

- Krijimi i një kuadri rregullator që mundëson menaxhimin e konflikteve mes përdoruesve të ujit, zhvillimit të planifikimit urban dhe rural dhe brezave të ndryshëm;

- Në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni vendës dhe evropian, ndërmerren masa për të krijuar marrëdhënie të mirë institucionale dhe për të pasur bashkëpunim sa më të mirë ndërkufitar.

- Promovimi i monitorimit të rregullt të politikave dhe qeverisjes ujore, ndarja e rezultateve me publikun dhe përmirësimi i tyre, sa herë që është e mundur.

2.2 Aktorët kryesorë

Nga pikëpamja e kuadrit institucional ka një numër të konsiderueshëm aktorësh që kontribuojnë në rregullimin e burimeve ujore, interesi, ndikimi dhe roli i të cilëve duhet marrë në konsideratë gjatë zbatimit të këtij projekti. Mbështetur në analiza të mëparshme, janë identifikuar 71 aktorë, nga të cilët: i. 5 institucione kanë më shumë funksione drejtuese që fokusohen në politikëbërjen për sektorin ujor; ii. 14 institucionet kanë kryesisht funksione drejtuese/kryesuese dhe janë përgjegjëse për proceset e planifikimit, zbatimit, monitorimit, vlerësimit dhe zbatimit të ligjit; iii. 32 institucione kanë kryesisht funksione menaxhuese, fokusohen në proceset e monitorimit dhe kontrollit; iv. vetëm 8 institucione kryejnë funksione operacionale dhe janë përgjegjëse për zbatimin e punës; v. 12 institucione kryejnë funksione dhe procese të përziera.

Si më poshtë gjendet një përshkrim i aktorëve kyç institucionalë dhe rolit të tyre në fushën e burimeve ujore:

1. Këshilli i Ministrave është organi më i lartë vendimmarrës i qeverisë për të gjitha çështjet thelbësore që lidhen me sektorin e ujit.

2. Komiteti i Planifikimit Strategjik (KPS) aprovon prioritetet/drejtumet bazë të strategjisë për zhvillimin e vendit, strategjitë kombëtare, sektoriale dhe ndërsektoriale, përkufizon dhe aprovon kuadrin e PBA-së, merr vendime strategjike për tavanet buxhetore, programet dhe projektet e mëdha të investimeve publike; realizon koordinimin strategjik të ndihmës së huaj me komunitetin e donatorëve, monitoron dhe vlerëson ecurinë në përmbushjen e prioritetëve, programeve, investimeve kryesore dhe riprogramimin e tyre.

3. Këshilli Kombëtar i Ujit (KKU) është organi qendror vendimmarrës për menaxhimin e burimeve ujore.

4. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore është një institucion publik, buxhetor, në varësi të Kryeministrit, i krijuar me ligjin e veçantë (nr. 6/2018). AMBU-ja është institucioni kryesor qendror përgjegjës për menaxhimin e integruar të burimeve ujore.

5. Ministrinë e linjës (MBZHR, MIE, MSHMS, MTM, MB) janë përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e politikave në sektorë ku fusha e tyre e përgjegjësisë mbivendoset/ndërlidhet me sektorin e ujit dhe menaxhimin e burimeve ujore.

6. Komisionet/ komitetet për organet specifike ujore, përgjegjëse për zbatimin e politikave në fushën e tyre të përgjegjësisë.

7. Këshillat e baseneve ujore (KBU) janë organe vendore përgjegjëse për menaxhimin e burimeve ujore në basenet përkatëse, ku fokusohen në aprovimin e lejeve/autorizimeve dhe planeve për menaxhimin e tyre.

8. Zyrat e administrimit të baseneve ujore (ZABU-të) janë degë/drejtori rajonale të AMBU-së, përgjegjëse për hartimin e inventarëve të burimeve ujore si në sasi dhe cilësi, menaxhimin e kërkesave për leje/autorizimeve, monitorimin e përdorimit të ujit, prodhimin e raporteve periodike për KBU-në.

9. Prefektët kanë rolin kryesor në nivel vendor për planifikimin e emergjencave civile dhe menaxhimin e krizave brenda kufijve të tyre administrativë.

10. Drejtoritë rajonale të ujitjes dhe kullimit (Lezha, Fier, Durrës, Korça) janë përgjegjëse për përdorimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të ujitjes dhe kullimit, si dhe për marrjen e masave mbrojtëse nga përmytjet brenda fushës së tyre të veprimtarisë, për largimin e ujit të tepërt, parandalimin e grumbullimit të ujit dhe përmytjeve.

11. Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG) është përgjegjës për administrimin e gjeoinformacionit dhe koordinon punën midis aktorëve të ndryshëm që kanë përgjegjësi në mbledhjen, gjenerimin, përpunimin dhe përditësimin e gjeoinformacionit, përfshirë çështje që lidhen me burimet ujore si hidrografia dhe hidrologjia, për të garantuar se informacioni gjeohapësinor është i plotë, i saktë, i përditësuar dhe i lehtë për t'u aksesuar nga të gjithë aktorët.

12. Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit (ISHMPUT) është përgjegjës për inspektimet në fushën e ujit, në përputhje me legjislacionin për ujin dhe kuadrin ligjor për inspektimet.

2.3 Përdoruesit kryesorë të ujit

Ky projekt, nëpërmjet produkteve dhe komponentëve të detajuar në këtë dokument, parashikon të përmirësojë performancën e sektorit duke plotësuar nevojat e përdoruesve të ujit, lehtësimin e shërbimeve për ta dhe përmirësimin e treguesve që lidhen me menaxhimin e burimeve ujore. Roli i përdoruesve të ujit është i rëndësishëm për suksesin e projektit, kështu që konsultimi me ta do të jetë pjesë e punës gjatë dizenjimit të projektit, planifikimit të punës, formulimit të zgjidhjeve/dispozitave dhe zbatimit të tyre. Siç përkufizohet në një numër dokumentesh, katër kategoritë kryesore të përdoruesve të ujit që ndërveprojnë dhe përfitojnë nga ky projekt janë:

- ujë për njerëzit që lidhet me ujin e pijshëm dhe shërbimin e kanalizimeve;
- ujë për ushqimin që lidhet me bujqësinë;
- ujë për industrinë që përfshin energjinë hidrike, burimet hidro-termike, veprimtaritë e industrisë së lehtë dhe të rëndë, menaxhimin e mbetjeve të ngurta, peshkimin dhe akuakulturën, peshkimin sportiv dhe argëtimin;
- ujë për mjedisin që përfshin zonat e mbrojtura, ligatinat dhe pyjet.

2.4 Ndikimi i projektit tek AMBU-ja

Krijimi i AMBU-së si institucion qendror në varësi të Kryeministrit, me funksione politikëbërëse dhe zbatuese, pritet që të sjellë ndryshime të konsiderueshme në rregullimin e burimeve ujore, krijimin e një modeli të ri që përpaket të adresojë çështje thelbësore që evidentohen në shumë dokumente sektorialë. Megjithatë, krijimi i një institucioni të ri, qëllimi i të cilit është t'i japë një shtysë zhvillimit të sektorit, duke e orientuar në drejtimin e duhur, me një theks të veçantë në menaxhimin e integruar dhe qëndrueshmërinë e burimeve ujore, është një sfidë në shumë drejtime. Për këto arsye, është e nevojshme të zbatohet projekti që po propozojmë, i cili do të mundësojë transformimin e AMBU-së në një institucion plotësisht operacional që do të jetë në gjendje të materializojë ndryshimet e nevojshme, mbi mënyrën sesi menaxhohen burimet ujore në Shqipëri. Në përgjithësi, ky projekt synon të përmbushë disa produkte që do të forcojnë dhe institucionalizojnë kapacitetet e AMBU-së:

- Organizimi i AMBU-së si një sistem plotësisht funksional me të gjithë komponentët që duhen për të garantuar orientimin strategjik dhe harmonizimin me prioritetet qeveritare, përcaktimin e TKP-ve për matjen e ecurisë dhe arritjeve, garantimin e një procesi vendimmarrës efektiv, organizimin e duhur funksional, proceset e brendshme të punës dhe procedurat, komunikimin dhe ndërveprimin efikas, përshkrimin e detajuar të punës dhe komponentëve të tjerë që lidhen me performancën institucionale;

- Zhvillimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore, njohuritë teknike institucionale, aftësitë teknike dhe ekspertizën duke trajnuar dhe mbështetur stafin e AMBU-së dhe duke ngritur sistemet e informacionit dhe të të dhënave;

- Krijimi i ndërfaqes dhe mekanizmave të koordinimit për integrimin sektorial dhe bashkëpunimin ndërmjet aktorëve, si dhe për rritjen e përfshirjes në procese vendim-marrëse (Kryeministria, ministrinë e linjës, KKKU-ja, GIMP-ja, komitetet strategjike dhe komisionet ndërkufitare, njësitë e qeverisë vendore, bizneset, OJQ-të, komunitetet dhe qytetarët.

- Ofrimi i informacionit dhe aksesit të nevojshëm qytetarëve për të garantuar transparencën, dhe për të trajtuar rastet e mundshme të korrupsionit dhe shpërdorimit të detyrës, sjelljet e papërshtatshme dhe joetike, aktivitetet e paligjshme në basenat e lumenjve, garantimin e përputhshmërisë me detyrimet ligjore dhe krijimin e një sistemi për raportimin dhe trajtimin e ankesave.

2.5 Teoria e ndryshimit (TN)

TN-ja është baza mbi të cilën është përgatitur korniza e rezultateve. Modeli TN gjendet në faqen pasardhëse, e përfaqësuar nga katër lloje ngjyrash:

Blu: Supozimet e secilës prej palëve për Teorinë e Ndryshimit;

E gjelbër: Logjika e ndërhyrjes;

E verdhë: Perspektivat ndërsektoriale;

E kuqe: Zinxhiri i rezultateve që lidh logjikën e ndërhyrjes.

Ndikimi

Në përgjithësi projekti do të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të ujit (në përputhje me direktivat e BE-së, OZHQ-të dhe prioritetet kombëtare), duke mbështetur AMBU-në për të përmirësuar proceset vendimmarrëse, të cilat shërbejnë për përfitimin mjedisor dhe socio-ekonomik (duke mbajtur parasysh gjininë, përkatësinë etnike, situatën socio-ekonomike etj.).

Supozimet janë se ekziston vullneti themelor politik, social dhe ekonomik dhe këmbëngulja për të marrë vendime të bazuara në dëshmi, nga të cilat do të përfitojnë një grup i gjerë qytetarësh.

Reduktimi i varfërisë është një nga synimet kryesore në planin afatgjatë të ndërhyrjes për të zvogëluar konfliktet, duke supozuar se vendimmarrja e bazuar në evidenca do të krijojë një agjendë gjithëpërfshirëse.

Rezultatet afatmesme

Një parakusht për arritjen e ndikimit është që AMBU-ja të shndërrohet në një institucion plotësisht funksional, efektiv dhe efikas në përmbushjen e funksioneve, detyrave dhe përgjegjësi të saj ligjore.

Supozimi është se qëndrueshmëria e ndërhyrjeve për të dhëna statistikore garantohej nga personat përgjegjës duke siguruar alokimin e përshtatshëm të burimeve (financimit dhe burimeve njerëzore), si dhe ofrimin e mbështetjes së nevojshme politike për angazhimin afatgjatë për të ndërtuar sisteme statistikore kombëtare dhe rajonale.

Ndërgjegjësimi i nëpunësve përgjegjës dhe mbajtësve të të drejtave mbi nevojën për të punuar me barazinë gjinore dhe ndryshimet e mjedisit/klimës, p.sh., duke analizuar dhe shfrytëzuar të dhënat e ndara sipas gjinisë.

Rezultate afatshkurtër

Parakushti për rezultatin afatmesëm është: 1. Funksionimi i brendshëm i AMBU-së midis drejtorive, sektorëve dhe pozicioneve specifike të punës; dhe 2. Përmirësimi i funksionimit dhe ndërveprimit të jashtëm të Agjencisë me aktorët e tjerë sektorialë.

Supozimi është se strategjitë e komunikimit janë zbatuar dhe janë efektive, p.sh. duke u siguruar se ato janë përshtatur për grupet e synuara, se angazhimi palëve kyç të interesuara është efektiv dhe gjithëpërfshirës, që zbatimi i ndërhyrjes të kryhet sipas planit dhe/ose është strategjik dhe fleksibël. Përpjekjet për integrimin e tyre supozohet të jenë efektive.

Rezultatet do të kontribuojnë për të kuptuar nevojën për të punuar me barazinë gjinore dhe ndryshimin e mjedisit/ klimës, p.sh. duke pasur akses në të dhëna të analizuara nga perspektiva të ndryshme.


Produktet

Parakushtet për përmbushjen e rezultateve afatshkurtra ilustrohen në produkte të ndryshme të mundshme, përfshirë: 1. Zhvillimin, pranimin, dhe komunikimin e planifikimit strategjik; 2. Zhvillimi i procedurave për funksionimin e brendshëm, përfshirë rolet dhe përgjegjësitë; 3. Forcimi i kapacitetit për të punuar me çështje ndërsektorale si pjesë e integruar e menaxhimit të burimeve ujore (sidomos për konfliktet, barazinë gjinore, ndryshimin mjedisor/klimaterik); 4. Zhvillimi i strukturave dhe sistemeve të brendshme të komunikimit për të mbështetur vendimmarrjen, 5. Zhvillimi i komunikimit të jashtëm strategjik; përfshirë angazhimin me aktorët qendrorë dhe vendorë në vendimmarrje, si dhe me qytetarët dhe përdoruesit e ujit në veçanti, 6. Sqarimi i roleve dhe ndërveprimi me komponentin e mjedisit dhe aktorët për të dhënë informacion për rregullimin e burimit ujor dhe 7. Krijimi i sistemit të menaxhimit të riskut nga uji (mungesë ose tepriçë uji).

Supozimet janë, p.sh.: angazhimi i palëve të interesuara me aktorët kryesorë është efektiv, se ndërhyrja është zbatuar siç është planifikuar (dhe përshtatet sipas nevojës) dhe se mbështetja nga donatorët e mundshëm është strategjike dhe fleksibël. Përveç kësaj, supozimi është se integrimi i perspektivave është i favorshëm. Disponueshmëria e burimeve njerëzore dhe partnerëve është gjithashtu një supozim.

Janë zbatuar ndryshimet e mjedisit/klimaterike, p.sh. në metoda, komunikim dhe shpërndarje gjatë ndërhyrjes së projektit. Përveç kësaj, barazia është në fokus, p.sh. duke siguruar se shanset për punësim zbatohen njësoj si për burrat dhe për gratë, se janë rritur lidhjet sociale dhe gjinore në menaxhimin e burimeve ujore dhe se janë parashikuar në produkte të tjera.

Modeli i teorisë së ndryshimit



2.6 Rezultatet dhe aktivitetet e projektit

Projekti, duke zbatuar logjikën e ndërhyrjes së TN-së dhe pa përsëritur këto në ndikimin e rezultatit afatmesëm, pritet që të realizojë si më poshtë:

Rezultati i pritshëm afatshkurtër 1: Funksionim i përmirësuar ndërmjet drejtorive, sektorëve dhe pozicioneve specifike

Produkti 1.1. Zhvillimi, miratimi dhe komunikimi i planifikimit dhe organizimit strategjik të AMBU-së

Puna përfshin nevojat më poshtë:

- Përcaktimin e vizionit dhe qëllimeve afatgjata të AMBU-së, sqarimin e përgjegjësive dhe priorizimin e programeve dhe projekteve që duhet të zbatojë AMBU-ja vitet vijuese;
- Përkufizimin e objektivave dhe TKP-ve për të matur performancën e brendshme;
- Përkufizimin e objektit të punës dhe detajimin e planit të punës së AMBU-së, i cili përcakton rolet dhe përgjegjësitë e strukturave të AMBU-së, aktivitetet prioritare, produktet dhe shërbimet që duhet të sigurojë AMBU-ja;

- Vlerëson nevojat buxhetore të AMBU-së, bazuar në planin konkret të punës, duke mbajtur parasysh se çfarë është në gjendje të bëjë AMBU-ja me personelin dhe fondet, përfshirë produktet që mund t'i nënkontraktohen palëve të treta, si dhe një parashikim kostosh; një parashikim të të ardhurave nga burimet e veta të AMBU-së, nëse ka, dhe shumën e nevojshme të financimit nga buxheti i shtetit, si dhe nga financime të mundshme donatore;

- Analizon proceset dhe flukset e punës;
- Përgatit procedurat dhe përgjegjësitë;
- Analizon implikimet e mundshme ligjore, bën sugjerime për ndryshime;
- Zhvillon një strategji afatgjatë të AMBU-së (planin e punës) me TKP-të;
- Zhvillon politika gjinore për rekrutimin, mbajtjen dhe rritjen në detyrë në bazë të performancës dhe meritës (me synim shanse të barabarta të rritura);
- Zhvillon politika mjedisore për AMBU-në si institucion.

Produkti 1.2 Zhvillimi i procedurave për funksionimin e brendshëm, përfshirë përcaktimin e roleve dhe përgjegjësive.

Puna përfshin këto nevoja:

- Analizën e proceseve dhe riinxhinierimin e tyre: kjo përfshin identifikimin, të kuptuarin dhe analizën e proceseve që ndodhin në agjenci, ndërmjet drejtorive të ndryshme, niveleve hierarkike, nivelit qendror dhe atyre të basenit. Kjo analizë ka qenë hapi i parë, i cili do të vijojë me ridizenjimin ose riinxhinierimin e proceseve dhe evidentimin e proceseve, që nënkupton vendosjen e gjithë hapave dhe vendimeve të proceseve riinxhinierike në një diagramë. Evidentimi i proceseve do të pasqyrojë fluksin e proceseve ndërmjet drejtorive dhe strukturave në agjenci, horizontalisht dhe vertikalisht, përfshirë rolin dhe angazhimin e zyrës qendrore dhe ZABU-së në zbatimin e proceseve të ndryshme;

- Manuali i procedurave: është ndarja e procedurave në procese pune ku përkufizohet roli i gjithsecilit, kohëzgjatja/afati kohor për çdo hap dhe i procedurës në përgjithësi, strukturat ose pozicionet përgjegjëse, përgjegjësitë e sakta, varësitë dhe lidhjet;

- Udhëzimet e punës: Hartimi i një formati udhëzimesh dhe përgatitja e tre problematikave të zgjidhura që do të përdoret nga personeli për të përgatitur gjithë setin e udhëzimeve të punës. Udhëzimet e punës duhet të plotësohen dhe të detajohen nga personeli i AMBU-së për shkak të dijes teknike dhe profesionale;

- Analiza e proceseve duhet të marrë në konsideratë mënyrën sesi do të integrohen aspektet sociale/gjinore në fluksin e punës, p.sh. në lidhje me si/kush dhe pse janë orientuar ToR-et për investime në përputhje me kërkesat ndërkombëtare;

- Hartimi i manualit të procedurave, pra fluksi i punës dhe sistemet për kontrollin e cilësisë mbrojnë aspektet sociale/gjinore në përputhje me kërkesat e BE-së;

- Zhvillimi i udhëzimeve të punës – për të siguruar se reflekton edhe në praktikë analizën dhe manualin e kërkesave sociale/gjinore;

Produkti 1.3 Kapacitet i forcuar për të punuar me çështje ndërsektoriale, si pjesë e integruar e menaxhimit të burimeve ujore (në veçanti konflikti, barazia gjinore, ndryshimi i mjedisit/klimës).

Puna përfshin këto nevoja:

- Analizën e përshkrimeve të punës, të rishikuara dhe të zhvilluara nëpërmjet një qasje gjithëpërfshirëse, çfarë hallkash funksionojnë në zinxhirin e nevojshëm për të mbrojtur çështjet ndërsektoriale;

- Analizën e implikimeve të mundshme ligjore, dhënien e sugjerimeve për ndryshime;

- Vlerësimin e nevojave mbi kapacitetin për të trajtuar çështjet ndërsektoriale, përfshirë nivelet e njohurive, sistemet ekzistuese, alokimin e burimeve, aksesin në mjete etj., zhvillimin e rekomandimeve për të rritur kapacitetet;

Zhvillimin e kapaciteteve, në varësi të vlerësimit të nevojave, p.sh.:

- Menaxhimi i konfliktit dhe zgjidhjet për rastet që lidhen me menaxhimin e burimeve ujore (me raste konkrete);

- Vlerësim mbi ndikimin social në investimet e mëdha (lidhjen dhe të kuptuarin e kërkesave/standardeve të mjedisit/sociale për investitorët e mundshëm);

- Lidhjen ndërmjet menaxhimit të burimeve ujore dhe barazisë gjinore.

Produkti 1.4 Strukturat e komunikimit të brendshëm dhe sistemeve të zhvilluara për të mbështetur vendimmarrjen

Puna përfshin nevojat si më poshtë:

- Sistemin e vendimmarrjes së AMBU-së: Ky produkt duhet të sigurojë vendimmarrje objektive dhe efektive, duke marrë parasysh marrëdhëniet hierarkike dhe mënyrën e raportimit midis drejtorive të ndryshme brenda AMBU-së dhe ndërmjet nivelit qendror dhe ZABU-ve, duke përcaktuar dhe adresuar këto çështje:

- llojet e vendimmarrjeve brenda AMBU-së (çfarë procesi vendimmarrës kemi në organizatë?);

- vlerëson dhe mat ndikimin e vendimmarrjes;

- procesin/procedurat vendimmarrëse për llojet/kategoritë e ndryshme të problemeve (në përgjithësi kjo përfshin këta hapa: identifikimin e problemit/çështjes, mbledhjen e informacionit, analizën, propozimin e zgjidhjeve, peshimin e alternativave, marrjen e vendimit, monitorimin e efekteve të vendimit);

- shpërndarja e vendimmarrjes/kompetencave brenda organizatës (pema e pushtetit ose autoritetit);

- sistemi i komunikimit të brendshëm: Sistemi duhet të sigurojë komunikim në kohë, efektiv dhe efikas dhe të kuptuarin njësoj midis drejtorive të ndryshme brenda AMBU-së (horizontalisht) dhe midis nivelit qendror dhe ZABU-ve (vertikalisht) duke përfshirë shkëmbimin, qasjen dhe përdorimin e duhur të përmbajtjes së komunikimit duke trajtuar këto çështje:

- përcaktimi i mesazheve që do të komunikohen dhe përmbajtjes së tyre (Çfarë po komunikohet?);

- llojet e komunikimit dhe rrjedhën e komunikimit (Si ndodh komunikimi?);

- gjuha e organizatës, terminologjia, konceptet dhe të kuptuarin e përbashkët;

- forma dhe kanalet e komunikimit;

- subjektet që marrin pjesë në procesin e komunikimit (Kush komunikon me kë?);

- përfundimi i përshkrimeve të punës: komponentët më sipër të programit për funksionimin e brendshëm (plani i punës, manuali i proceseve/procedurave, udhëzimet e punës) dhe dy nënkomponentë të komponentit të organizimit të brendshëm të AMBU-së (vendimmarrja dhe sistemi i komunikimit) kontribuojnë për të përgatitur përshkrime pune të hollësishme, konkrete dhe të integruara, për të gjithë pozicionet në AMBU. Në total, AMBU-ja ka një personel prej 82 personash. Duke pasur parasysh se 6 përshkrime pune kanë përfunduar, kanë mbetur për t'u hartuar edhe 76 përshkrime pune.

- Analiza e strukturave vendimmarrëse brenda AMBU-së në fushën e burimeve njerëzore (p.sh. garantimi se organizata i përmbush standardet kombëtare dhe ndërkombëtare në lidhje me

ekuilibrimin e punës / jetës, ngacmimet / ngacmimet seksuale, mundësitë e barabarta, paga të barabarta për punë të barabartë / punë me vlerë të barabartë në përputhje me direktivën e BE-së dhe me legjislacionin kombëtar).

Produkti 1.5 Infrastruktura e duhur në AMBU

Kjo paketë përfshin përmbushjen e nevojave si më poshtë:

- Sigurimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, përfshirë programe, kompjuterë, laptopë, servera, rutura, çelësa, printera, skanera etj.

Dy kategori të tjera që lidhen me infrastrukturën, që janë identifikuar si nevoja, por nuk janë pjesë e këtij projektpropozimi janë:

- Ambiente dhe zyra të përshtatshme: përfshirë rehabilitimin/restaurimin, instalimin e rrjetit elektrik, sistemin e ngrohje-ftohjes etj.

- Pajisjet dhe mjetet e punës: përfshirë mobilet, mjete pune dhe pajisje, automjete etj.

Rezultati i pritshëm afatshkurtër 2: Përmirësimi i funksionimit dhe ndërveprimit të jashtëm të Agjencisë me aktorët e tjerë sektorialë

Produkti 2.1 Zhvillimi i komunikimit të jashtëm strategjik

- Analizon materialet e Strategjisë MIBU dhe PMBU në lidhje me angazhimin e aktorëve dhe metodat për kontaktimin e tyre;

- Zhvillon procedura për angazhimin me aktorët e ndryshëm;

- Zhvillon procedura për angazhim më të gjerë për të garantuar gjithëpërfshirjen e barabartë të grave, burrave, vajzave dhe djemve në vendndodhje të ndryshme (përfshirë kontaktin me OJQ-të, si organizatat e grave dhe organizatat për mjedisin);

- Zhvillon/përshtat metodat ekzistuese të pjesëmarrjes për takimet me publikun (me qëllimin e qartë të rrisë zërin e grave);

- Analizon fluksin e punës për llojet e ndryshme të proceseve të angazhimit, p.sh. duke përdorur si shembull PMBU;

- Vlerësimi i nevojave për trajnim.

Forcimi i kapaciteteve në:

- Komunikimin strategjik;

- Gjithëpërfshirjen sociale dhe pjesëmarrjen e barabartë gjinore;

- Përgatitjen e ToR për sektorin e ujit duke mbajtur parasysh angazhimin e gjerë;

- Aktivitete strategjike dhe fushata për grupet e synuara (p.sh. të kontaktohen djem të rinj, gra në moshë etj.).

Produkti 2.2 Forcimi i angazhimit të Kryeministrit, KKU-së, GIMP-së, komiteteve strategjike dhe komisioneve ndërkufitare

Është shumë i rëndësishëm bashkëpunimi ndërmjet këtyre aktorëve që nënkupton shkëmbimin që ndodh ndërmjet këtyre institucioneve, sinergjitë midis tyre, fluksin e vendimarrjes, informacionin / njohuritë, financat dhe burimet, prioritetet dhe strategjitë, propozimet, analizat dhe sugjerimet.

Ky komponent përfshin një numër elementesh:

- Identifikimi dhe vlerësimi i aktorëve;

- Caktimi i pikave të kontaktit dhe përkufizimi i funksioneve për çdo aktor;

- Përgatitja e angazhimit, ndërveprimit, procesit/procedurës së ndërveprimit (Çfarë po shkëmbehet dhe si?);

- Zgjerimi i rolit të AMBU-së dhe KKU-ve dhe forcimin e marrëdhënieve mes tyre duke shkëmbyer energjitë e përbashkëta.

Produkti 2.3 Bashkëpunim i përmirësuar me njësitë e qeverisë vendore, ZABU, komunitetet dhe qytetarët

Ky produkt përmban elementet ose nënkomponentët si më poshtë:

- Identifikimi dhe vlerësimi i aktorëve;

- Caktimi i pikave të kontaktit dhe përkufizimi i funksioneve për çdo aktor;

- Përcaktimin e bashkëpunimit dhe proceseve/procedurave (Çfarë shkëmbimesh ndodhin?);

- Përmirësimi dhe konsolidimi i bashkëpunimit.

Produkti 2.4 Ndërveprim i përmirësuar i AMBU-së me përdoruesit e ujit

Ky komponent parashikon ndërveprimin e AMBU-së me përdoruesit e ujit sipas 4 kategorive kryesore të përdorimit të ujit (uji për njerëzit, uji për industrinë dhe energjinë, uji për ushqim dhe uji për turizëm dhe rekreacion). Ia vlen të theksohet se ka një shumëllojshmëri të gjerë të përdoruesve të ujit, të përfaqësuar nga ministritë që mbulojnë fushat e përgjegjësisë që rregullojnë katër drejtimit e përdorimit të ujit. Këto ministri kanë agjencitë vartëse, si: AKBN-ja, AKUM-ja, ujësjellës-kanalizime, bizneset që përdorin ujin për qëllime tregtare (industria, prodhimi i energjisë, turizmi, prodhimi i ushqimit etj.) dhe, gjithashtu, familjet dhe individët që përdorin ujë për qëllime jokomerciale ose përdorim personal. Ky komponent përfshin elementet e mëposhtme:

- Sistemi i lejeve/autorizimeve për 4 kategoritë e përdoruesve të ujit: përfshirë dispozitat/rregulloret mbi të drejtat për përdorimin e ujit, rihartimin e procesit të lejeve, adoptimin e ndryshimeve ligjore, forcimin e kapaciteteve të sistemit të ri, krijimin e infrastrukturës dhe teknologjisë për realizimin e procesit. Aktualisht ekziston një procedurë për dhënien e lejeve/autorizimeve për përdorimin e ujit. AMBU-ja po punon që të integrojë *on-line*, sistemin e lejeve/autorizimeve për përdorimin e ujit, te sistemi qeveritar shqiptar (*e-Albania*), ku ofrohen një sërë shërbimesh të tjera. Sistemi lejon çdo përdorues të aplikojë direkt *on-line*, duke shmangur kështu nevojën për të qenë fizikisht të pranishëm në institucion dhe për të komunikuar drejtpërdrejtë me nëpunësit e institucionit. Thjeshtëzimi dhe lehtësimi i procedurave për marrjen e lejeve dhe shërbimeve të tjera është pjesë e reformës së derregullimit që ka ndërmarrë qeveria shqiptare (si pjesë e komponentëve të reformës së qeverisë) për përmirësimin e shërbimeve publike. Ky komponent do të përfshijë vlerësimin e praktikave më të mira për të përmirësuar procesin ekzistues dhe pritet të sjellë më shumë transparencë, drejtësi dhe barazi gjatë rishikimit të aplikimeve, më pak komplikacione për aplikantët, procedurë më të shpejtë dhe më të lehtë për të marrë lejet, eliminimin e sjelljes korruptive dhe shpërdorimit të detyrës, si dhe përfitimeve të tjera që lidhen me cilësinë e shërbimit drejt qytetarëve. Për sa i përket fizibilitetit (fizibilitetit financiar dhe kohor), ky i fundit konsiderohet i mundshëm, meqenëse platforma është e ngritur dhe funksionale bazuar në strategjinë e qeverisjes elektronike (*e-Albania*) zbatuar nga qeveria shqiptare;

- Sistemi për vlerësimin e performancës së përdoruesve të ujit: përfshin përcaktimin e prioritetëve të përdorimit të ujit, vlerësimin e sasisë dhe cilësisë së ujit para dhe pas përdorimit, analizën e performancës, produktivitetin dhe vlerën ekonomike të përdorimit të ujit, harmonizimin me direktivat e BE-së dhe përmbushjen e përgjegjësisë që lidhen me cilësinë dhe efikasitetin e përdorimit të ujit. Në këtë kontekst është e rëndësishme për të kuptuar, sqaruar dhe zbatuar siç duhet përgjegjësitë institucionale që rrjedhin nga direktiva kuadër e ujit dhe direktiva të tjera plotësuese dhe specifike që kanë të bëjnë me burimet ujore;

- Sistemi për monitorimin e ujit: monitorimi i sasisë dhe cilësisë së ujit para dhe pas përdorimit, vendosjen e tarifave të ujit, mbledhjen e të ardhurave, për secilën nga 4 kategoritë kryesore të përdorimit të ujit.

Produkti 2.5 Sqarimi i roleve dhe ndërveprimi me komponentin e mjedisit dhe aktorët që japin kontributin e tyre për rregullimin e burimeve ujore

Ky produkt përfshin mekanizma bashkëpunimi të institucioneve që garantojnë burimet dhe input-et e nevojshme për funksionin e sektorit të burimeve ujore, përfshirë:

- Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit: Uji është një element themelor i mjedisit që ndikon mjedisin në tërësi, prandaj ministria përcakton standardet mjedisore (cilësore dhe sasiore) në lidhje me ujërat, që duhet të respektohen dhe gjithashtu vlerëson ndikimin mjedisor të shkaktuar nga përdorimi i ujit. Për MTM-në është e rëndësishme të përcaktojë dhe të krijojë marrëdhëniet e duhura ndërmjet AMBU-së dhe sektorit të burimeve ujore me SANE 27 dhe zbatimin e direktivave të BE-së, duke renditur përgjegjësitë e AMBU-së për zbatimin dhe monitorimin e

disa aktiviteteve dhe funksioneve në kuadër të SANE 27 dhe direktivave të BE-së që prekin burimet ujore.

- AMBU: është përgjegjëse për financimin e sektorit, sigurimin e fondeve për investime dhe mbulimin e shpenzimeve administrative dhe operacionale.

- ASIG: është përgjegjës për vendosjen e standardeve që rregullojnë informacionin gjeohapësinor për çështje që lidhen me burimet ujore dhe kadastrën ujore, gjithashtu, për ofrimin e ekspertizës dhe të dhënave të informacionit gjeohapësinor.

- DAP: është përgjegjës për rekrutimin e burimeve njerëzore në shërbimin civil (përfshirë institucionet që merren me menaxhimin e burimeve ujore), për krijimin dhe mbikëqyrjen e sistemit të vlerësimit të performancës së punonjësve, si dhe të motivimit dhe shpërblimit.

- AKSHI: është përgjegjës për administrimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në institucionet e administratës publike, përfshirë bazat e të dhënave dhe programet, prokurimin dhe mirëmbajtjen e teknologjisë.

Produkti 2.6 Sistemi për menaxhimin e riskut nga uji (mungesë ose teprice uji)

AMBU-ja mbështetet në sistemin ekzistues të menaxhimit të rrezikut të trashëguar nga STKKU, megjithatë këto sisteme duhet të përmirësohen në mënyrë që të jenë efektive, pasi nuk ka qenë asnjëherë në të vërtetë funksionale. Është e rëndësishme të theksohet se në strukturën e re organizative të AMBU-së është parashikuar një seksion i dedikuar menaxhimit të riskut (Sektori i Menaxhimit të Riskut dhe Mbrojtjes së Burimeve Ujore) nën Drejtorinë e Menaxhimit të Performancës. Në thelb, nëpërmjet këtij produkti, kjo strukturë do të mbështetet, trajnohet dhe zhvillohet më tej për të krijuar një sistem të duhur të menaxhimit të rrezikut dhe që funksionon në përputhje me rregullat dhe procedurat përkatëse. Ky komponent konsiderohet i realizueshëm brenda kohës së caktuar dhe buxhetit, pasi institucioni ka përvojë të mëparshme (d.m.th. jo gjithçka do të fillojë nga zeroja) dhe gjithashtu ekziston një strukturë e dedikuar që do të përqendrohet vetëm në menaxhimin e rrezikut dhe do të bashkëpunojë ngushtë me ekspertët ose konsulentët e caktuar për të ofruar ekspertizën dhe asistencën teknike për krijimin e këtij sistemi.

Ky sistem do të mundësojë mbrojtjen nga uji, si në rastet e tepricës (përmbajtje) apo në rastet e mungesës së ujit (thatësira). Përfshin elementet kyç si më poshtë:

- identifikimi dhe vlerësimi i risqeve;
- analiza dhe përcaktimi i masave zbutëse;
- përcaktimi i rolit dhe përgjegjësi të aktorëve për t'iu përgjigjur situatave emergjente dhe në lidhje me zbatimin e masave zbutëse (reagimi në raste emergjencash duhet të mbajë parasysh dallimet gjinore sipas Kuadrit Sendai);
- monitorimi i riskut dhe ndërhyrja në rast se materializohet.

Rezultati i pritshëm afatshkurtër 3: Nivele të rritura ndërgjegjësimi për përdorim të sigurt, të barabartë dhe të ligjshëm të burimeve ujore

Zyrat e administrimit të baseneve ujore do të luajnë një rol kyç, si dhe do të jenë përgjegjëse për përmbushjen e këtij rezultati pasi aktivitetet për secilin nga produktet, në thelb kontribuojnë në lidhjen e drejtpërdrejtë të përdoruesve të ujit me agjencinë, dhe ZABU-të si degë vendore janë shtrirë në territor për të pasur një bashkëpunim më intensiv dhe lidhje me përdoruesit e ujit. Drejtoria e Përgjithshme e AMBU-së do të fokusohet në supervizimin dhe monitorimin e aktiviteteve për të garantuar se janë përmbushur përfitimet e planifikuara. Përfaqësuesit e kategorive të përdorimit të ujit (katër kategoritë e përmendura më sipër) janë anëtarë të Këshillave të Baseneve të Lumenjve dhe kanë rolin e tyre në procesin vendimmarrës. Ky rezultat lidhet me detyrimin ligjor të AMBU-së për të informuar dhe për t'u konsultuar me aktorët për çështje që kanë ndikim te ta. Neni 91 "E drejta për akses dhe përdorim informacioni të burimeve ujore" i ligjit nr. 111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore" parashikon:

- Çdo person (fizik dhe juridik) ka të drejtën të aksesojë dhe të përdorë informacionin që lidhet me burimet ujore, që zotërojnë institucionet publike.

- Publikut i ofrohet informacioni për dokumentet bazë dhe të dhënat që përdoren për të përgatitur planet e menaxhimit të baseneve, si dhe mundësia të marrë pjesë në procese konsultimi, si dhe të japë komente për PMBU-të.

Ndërsa, vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 221/2018, “Për organizimin dhe funksionimin e AMBU-së” i cakton AMBU-së përgjegjësinë që të promovojë dhe të rrisë ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e burimeve ujore, të inkurajojë pjesëmarrjen e përdoruesve të ujit dhe të komunitetit në përdorimin ekonomik të ujit me anë të fushatave të ndërgjegjësimi, botimeve, konferencave, seminareve, forumeve dhe konsultimeve.

Produkti 3.1 Zbatimi i fushatës së ndërgjegjësimi të menaxhimit të burimeve ujore

Një mënyrë e mirë për të mësuar mbi temat që lidhen me ujin, është duke rritur ndërgjegjësimin për ujin dhe fushatat e veprimit, për të mësuar rreth temave që prekin drejtpërdrejtë komunitetin. Është një mënyrë e shkëlqyer për të edukuar studentët, mësuesit dhe familjet rreth ndikimit që ata vetë kanë në mjedis, si dhe t’iu ofrohen mjetet për të mbrojtur dhe ruajtur ujin.

Ky produkt do të përmbajë elementet e mëposhtme ose nënkomponentët:

- përgatitja e materialit bazë për informimin dhe tekstin e materialeve për grupet e synuara (për të parë si arrijnë mesazhet te burrat, gratë, vajzat dhe djemtë).
- përgatitja dhe prodhimi i broshurave për çështjet që lidhen me ujin në Shqipëri;
- vendoset ku do të shpërndahen këto materiale për të garantuar se do arrijë çdo grup të synuar (p.sh. nëse gratë janë një nga grupet specifike të synuara, atëherë materiali që do të përgatitet duhet të përshtatet për ta);
- organizimi i një fushate ndërgjegjësimi dhe veprimi për ujin në universitete;
- organizimi i një fushate ndërgjegjësimi dhe veprimi për ujin në shkolla;
- organizimi i një fushate ndërgjegjësimi dhe veprimi për ujin për komunitetet në zonat bregdetare.

Produkti 3.2 Zhvillohet softueri (programi) që raporton aktivitetet e jashtëligjshme në basenet ujore

Softueri i raportimit është një instrument që ndihmon qytetarët të denoncojnë në çdo moment shkeljen e ligjit dhe të kundërvajtësve, duke përmirësuar kështu zbatimin e ligjit me anë të pjesëmarrjes qytetare. Ky produkt do të përfshijë këto elemente:

- identifikimin dhe përkufizimin e informacionit që duhet përfshirë në sistem;
- identifikimin dhe vlerësimin e moduleve që duhet të ketë sistemi;
- dizenjimin e sistemit;
- përcaktimin dhe mënyrën e raportimit.

Produkti 3.3 Zhvillimi i një zgjidhjeje digjitale për të rritur transparencën dhe përfshirjen e qytetarëve në vendim-marrje (me shumë mundësi nëpërmjet një faqeje internet)

Ridizenjimi i faqes zyrtare të Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, synon që të krijojë më shumë transparencë në informimin e publikut. Ky produkt do të përfshijë elementet kyç si më poshtë:

- Dizenjimin e faqes së internetit si një strukturë të re që mundëson që informacioni publik të ketë formë më të strukturuar, bazuar në mënyrën sesi punon Agjencia për Menaxhimin e Burimeve Ujore;
- Vlerësimin dhe përfshirjen e informacionit rreth shërbimeve që ofron Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore;
- Përfshirjen e zyrave të administrimit të baseneve ujore dhe këshillave të baseneve ujore si struktura të AMBU-së;
- Lidhjen me platformën e Kadastrës Kombëtare të Burimeve Ujore;
- Rritjen e transparencës dhe përfshirjen e qytetarëve në vendimmarrje.

2.7 Integrimi i çështjeve ndërsektorale

2.7.1 Ndryshimi i mjedisit/klimës

Udhëtimi vajtje-ardhje drejt Shqipërisë kontribuon në ndotje. Ndërtimi i një projekti kryesisht me mbështetjen lokale, i cili do të minimizojë udhëtimet ndërkombëtare, do të ndihmonte në uljen e ndotjes. Edhe udhëtimet me automjete në Shqipëri për të vizituar zyrat rajonale janë burim ndotjeje. Sa më sipër, do të bëhet planifikim dhe vendimmarrje e kujdesshme duke mbajtur parasysh mjedisin.

Përdorimi i materialeve: Printimi i materialeve do të shmanget sa herë që është e mundur. Megjithatë, aksesit i vogël në kompjuter (në basenet ujore) dhe varësia e lartë nga përdorimi i letrës, do ta bëjë gati të pamundur shmangien e printimit në praktikë. Në këtë fazë, masë zbutëse do të jetë dialogu në vazhdimësi për printimet e materialeve, dhe në rastet që është e nevojshme të merret në konsideratë lloji i letrës, printim nga të dyja anët dhe bardh e zi.

Ndryshimi mjedisor/klimatik ndikon në projekt. Ndikimi mjedisor për gjithë projektin vlerësohet si i ulët. Megjithatë, degradimi/fatkeqësitë mjedisore dhe/ose ndryshimi i klimës kanë ndikuar dhe do të vazhdojnë të ndikojnë punën e projektit në qarqe, pasi shumë veprimtari ndodhin në basenet e lumenjve.

Si pjesë e forcimit institucional, është parashikuar zhvillimi i një politike mjedisore për AMBU-në si institucion.

2.7.2 Aspektet sociale dhe barazia gjinore

AMBU-ja do të kërkojë ekipe me barazi gjinore për ofruesit e shërbimeve dhe ekspertët e fushës së barazisë gjinore që do të përfshihen në trajnime në lidhje me fushën sociale/gjinore dhe menaxhimin e ujit, duhet të ketë përvojë disaveqare në sektorin e menaxhimit të burimeve natyrore, mundësisht për ujë.

Materialet pedagogjike: Materialet me shkrim (përfshirë fotografitë) duhet të jenë të kenë parasysh gjininë dhe diversitetin, përfshirë (po jo vetëm) kush është portretizuar, si është portretizuar, gjuha e përgjithshme e përdorur, p.sh. të shmanget gjuha seksiste dhe përmbajtja stereotipike që lidhet me gjininë dhe diversitetin në përgjithësi.

Monitorimi dhe vlerësimi: Meqenëse njohuritë sociale në rritje që lidhen me investimet, si dhe gjinia janë drejtpërdrejtë pjesë e rezultateve, indikatorët, kur është e përshtatshme, duhet të jenë të ndarë sipas gjinisë, moshës, pozitës, vendndodhjes gjeografike në përputhje me kërkesat kombëtare.

Si pjesë e forcimit institucional, është parashikuar zhvillimi i një politike gjinore për AMBU-në si institucion.

2.8 Risku dhe zbutja e risqeve

Përshkrimi i riskut	Probabiliteti (1-5)	Impakti nëse ndodh (1-5)	Totali (1-25)	Masat për zbutjen e riskut
Zbatohen shumë produkte njëkohësisht në një sektor të ndërlikuar	4	4	16	Të rishikohet fizibiliteti gjatë fazës fillestare
Aktorët e jashtëm nuk priorizojnë si duhet ujë duke rrezikuar angazhimin e tyre me produktet kryesore	3	5	15	Plani në raste se ka vonesë në përgjigje dhe nevoja që AMBU-ja të marrë drejtimin e të gjithë aspekteve të rëndësishme të projektit
Kapaciteti i personelit të AMBU-së dhe menaxherëve për t'u angazhuar në vendimmarrje strategjike duke ju përgjigjur nevojave rastësore të qeverisë	3	4	8	Fleksibilitet i lartë në menaxhimin e projektit, përdorimi i metodave përfshirëse për t'u siguruar se stafi i kupton prioritetet strategjike të investimeve
Komponentët për forcimin e kapaciteteve në	4	4	16	Koordinimi i fortë i AMBU-së në komponentët e trajnimit për të dy

këtë projekt dhe projektet BE/ADA do të kërkojnë që marrësi (AMBU) të ketë personel (disa pozicione janë ende vakante), si dhe koha për dy projekte të mëdha intensive, me risqe të mundshme të për ty projektet				projektet me një kalendar të përbashkët për të dy projektet, duke kërkuar që projektet: 1. Të sigurojnë planifikimin e trajnimit paraprakisht dhe të sigurojnë projektet 2. Të përshtaten me kalendarin e AMBU (jo anasjelltas)
Rreziku i korrupsionit dhe shpërdorimit të detyrës për shkak të mandatit të zgjeruar të AMBU-së që përfshin përgjegjësitë lidhur me procesin e dhënies së lejeve dhe monitorimin e përdorimit të ujit.	2	4	8	Në lidhje me lejet, është detyrë e AMBU-së të menaxhojë procesin, ndërsa kompetenca për të vendosur ose miratuar lejet u jepet KBU-ve dhe KBU-së. Agjencia monitoron dhe ndjek zbatimin e rregullave dhe kushteve të lejeve dhe autorizimeve nga subjektet përkatëse; Zbatim i kujdesshëm i legjislacionit anti-korrupsion dhe strategjisë aktuale qeveritare mbi këtë temë (Strategjia ndërsektoriale kundër korrupsionit 2015-2020 dhe Plani i Veprimit) Fuqizimi i Sektorit Rregullator dhe Ligjor të Drejtorisë së Menaxhimit Strategjik për të siguruar përputhjen institucionale me kërkesat ligjore, kodin e sjelljes dhe etikës, mbrojtjen e sinjalizuesve. Zbatimi i aktiviteteve nën Rezultatit 3, që rrit transparencën dhe angazhimin e aktorëve (fushata, faqe interneti), lehtësimin e procedurave për të lejuar gjurmimin e procesit dhe duke e hedhur <i>on-line</i> , për të parandaluar aktivitetet e paligjshme falë platformës së raportimit <i>on-line</i> , shkurtimin e afateve kohore dhe përmirësimin e shërbimeve. Të gjitha këto aktivitete ndihmojnë për të parandaluar korrupsionin.
Mungesa e angazhimit, koordinimit dhe bashkëpunimit ndërmjet aktorëve institucional dhe kundërshtive të mundshme që sjellin përpjekje të shumëfishta dhe kaos.	4	4	16	Përgatitja e planit për angazhimin e aktorëve dhe të komunikimit. Krijimi i një strategjie për menaxhimin e konflikteve që fokusohet në parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve të mundshme institucionale. Përcaktimi i roleve dhe përgjegjësve në lidhje me zbatimin e projekteve.

3. Planifikimi i aktiviteteve

Sugjerohet të përdoret faza e fillimit për qëllime të ndryshme; kjo përfshin, ndër të tjera, sigurimin e mbështetjes. Së pari dhe më së shumti, pjesa kryesore e stafit të AMBU-së që do të angazhohen për projektin duhet të përmirësojnë TN-në, kornizën e rezultateve dhe të bëjnë rregullime sipas nevojës në buxhet (duke mos tejkaluar pragun e përgjithshëm). Gjithashtu, duhet të përcaktohet më tej një analizë e detajuar e palëve të interesit (parësore dhe dytësore). Nga ana tjetër duhet të zhvillohet një planifikim i detajuar për vitin e parë, duke marrë parasysh projektin e BE-së/ADA-së, duke detajuar procedurat e monitorimit dhe linjat e komunikimit me SIDA-n.

Faza fillestare është gjithashtu e rëndësishme për të zhvilluar dhe përpunuar më tej një numër çështjesh që nuk mund të përpunohen në fazën e tanishme, duke përfshirë analizën e kuadrit ligjor dhe institucional, organizimin dhe funksionet e aktorëve, përfundimin e buxhetit dhe çështjet e financimit, metodologjinë e punës, programin e punës dhe produktet e rezultatet e çdo faze të projektit.

[illegible]

Produkti 2.6 Sistemi i menaxhimit të riskut ujqor												
Rezultati 3 Nivele të rritura ndërgjegjësimi për përdorim të sigurt, të barabartë dhe të ligjshëm të burimeve ujore												
Faza fillestare (planifikimi, prokurimi, përdorimi)												
Produkti 3.1 Zbatimi i fushatës për menaxhimin e burimeve ujore												
Produkti 3.2 Zhvillimi i programit që raporton aktivitetet e jashtëligjshme në basenet ujore												
Produkti 3.3 Zhvillimi i zgjidhjeve digjitale për të rritur transparencën në përfshirjen e qytetarëve në vendimmarrje (nëpërmjet një faqe interneti)												
Monitorimi dhe mësimi												

4. Menaxhimi i projektit në AMBU

4.1 Organizimi i mënyrës së zbatimit

Zbatimi i përgjithshëm i aktiviteteve të këtij projekti do të jetë nën përgjegjësinë e drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë. Për aktivitetet e përfshira në çdo produkt, përgjegjësitë ndërmjet drejtorive të ndryshme të Agjencisë do të jenë si më poshtë:

- Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse do të jetë përgjegjëse për zbatimin e aktiviteteve të Rezultatit 1 dhe për koordinimin e tyre me drejtoritë e tjera të agjencisë, për aktivitete të ndryshme, kur nevojitet mbështetja e tyre.

- Drejtoria e Menaxhimit Strategjik dhe Drejtoria e Menaxhimit të Performancës do të jenë përgjegjëse për zbatimin e aktiviteteve të rezultatit 2 dhe për koordinimin me drejtori të tjera për aktivitete të ndryshme, kur nevojitet mbështetja e tyre.

- Drejtoria për Menaxhimin e Burimeve Ujore dhe Drejtoria për Menaxhimin e Performancës do të jenë përgjegjëse për zbatimin e projekteve të përfshira në rezultatin 3 dhe për koordinimin me drejtori të tjera në agjenci, për aktivitete të ndryshme, kur nevojitet mbështetja e tyre.

Struktura e re organizative e AMBU-së ka edhe një sektor që i është kushtuar projekteve që zbaton Agjencia. Ky seksion do të kryejë funksione të ngjashme me Njësinë e Zbatimit të Projekteve. Sektori i Projekteve të Brendshme dhe Koordinimit të Projekteve me Donatorët, është një nga tre sektorët në varësi të Drejtorisë së Menaxhimit Strategjik. Koordinimi, ndërfaqja dhe programimi i integruar i projekteve është një nga funksionet kryesore të këtij sektori, për të shmangur përsëritjet/dublikimet e energji dhe financimeve, për kanalizimin e mbështetjes dhe të investimeve mbështetur në nevojat konkrete të sektorit dhe prioritetet, për të garantuar menaxhimin efikas të projekteve, për të optimizuar burimet dhe për të maksimizuar përfitimet. Ky sektor do të jetë gjithashtu përgjegjës për përgatitjen e strategjive, për planifikimin e koordinimit dhe për të krijuar mekanizma që nuk do të garantojnë vetëm koordinimin midis projekteve të financuar nga donatorët (përfshirë projektin BE/ADA) por edhe të gjitha projektet e tjera që zbaton Agjencia, përfshirë projektet me financim dhe zbatim të brendshëm. Ky sektor do të jetë pika e kontaktit ose homologu i drejtpërdrejtë për të gjitha projektet që lidhen me menaxhimin e burimeve ujore.

4.2 Sistemi për monitorimin dhe ndjekjen

Projekti do të monitorohet në disa forma, që përfshijnë:

- monitorimi i vazhdueshëm i menaxhimit të projekteve për performancën e aktiviteteve për të realizuar produktin e pritshëm (kjo mund të përfshijë, për shembull, zhvillimin e një niveli

bazë për zbatimin e jashtëm, e cili mund të bashkohet me bazën e nevojshme për kryerjen e punës në terren (rezultati 3);

Workshop-e tremujore për rezultatet, në AMBU (përfshirë personelin e agjencive të baseneve ujore dhe drejtuesit), për të përcaktuar:

- Çfarë është bërë – nga pikëpamja e aktiviteteve;
- Çfarë është arritur – për sa i përket produkteve dhe treguesve;
- Për çfarë përshtatjesh ka nevojë - në lidhje me ndryshimet e jashtme;
- Për çfarë përshtatjesh ka nevojë – në lidhje me nevojat/ndryshimet e brendshme;
- Përditësimi i planit të punës sipas nevojës, përfshirë nevojën e mundshme për ndryshimin e indikatorëve dhe nëse nevojitet të riformulohen produktet e pritshëm në rast se bëhen pengesë për procesin;

- *Workshop* vjetor i aktorëve ku prezantohet dhe diskutohet ecuria e çdo produkti (përfshirë p.sh. donatorët;

- Raporti vjetor mbi progresin dhe sfidat (kundrejt rezultateve të pritshme afatshkurtra dhe produkteve).

Mekanizëm i përshtatshëm monitorimi që duhet zhvilluar gjatë fazës fillestare dhe kjo duhet kostuar në mënyrë të detajuar.

5. Menaxhimi financiar

5.1 Buxheti

Matrica më poshtë përmban një vlerësim paraprak të nevojave buxhetore të secilit nga produktet e parashikuara, mbështetur në përvojën e subjektit propozues, si dhe punë të ngjashme. Një vlerësim i detajuar dhe i saktë është parashikuar të përgatitet gjatë fazës fillestare të projektit, meqenëse kërkohet informacion dhe një analizë e detajuar për të zbërthyer secilin nga produktet. Qëllimi i këtij vlerësimi është të krijohet një ide fillestare dhe të vendosen disa tavanë të nevojave financiare për të ndihmuar në marrjen e vendimeve gjatë fazës së ideimit të projektit.

	Budget (€)
Buxheti total (rezultati 1, 2, 3 dhe monitorimi)	1,910,000
Rezultati 1 – funksionimi i brendshëm	535000
Faza fillestare (planifikimi, aprovimi, prokurimet, përdorimi)	5000
Produkti 1.1 Planifikimi strategjik dhe organizimi i AMBU-së zhvillohet, pranohet dhe komunikohet	90000
Produkti 1.2 Procedurat për zhvillimin e funksionimit të brendshëm, përfshirë rolet dhe përgjegjësitë	160000
Produkti 1.3 Kapacitet i forcuar për të punuar më çështjet sektoriale si pjesë e integruar e menaxhimit të burimeve njerëzore (në veçanti konflikti, barazia gjinore, ndryshimi i mjedisit/klimës).	40000
Produkti 1.4 Strukturat e komunikimit të brendshëm dhe sistemet janë zhvilluar për të mbështetur vendimmarrjen	40000
Produkti 1.5 Ngritja e infrastrukturës së duhur (vetëm struktura e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit)	100000
Rezultati 2 – funksionimi i jashtëm	935000
Faza fillestare (planifikimi, aprovimi, prokurimi dhe përdorimi)	5000
Produkti 2.1 Planifikimi i komunikimit strategjik dhe forcimi i kapaciteteve	40000
Produkti 2.2 Forcimi i pozicioneve të AMBU-së dhe angazhim më i madh me KM, KKU, GIMP, Komitetet Strategjike, Komisionet Ndërkufitare	100000
Produkti 2.3 Angazhim më i mirë i AMBU-së dhe më shumë ndërveprim me NjQV-të, ZABU-të, Komunitetet dhe qytetarët	120000
Produkti 2.4 Ndërveprimi i AMBU-së me qytetarët	250000

Produkti 2.5 Roli dhe ndërveprimi me komponentin e mjedisit dhe aktorët që ofrojnë kontributin e tyre për rregullimin e burimeve ujore	15000 0
Produkti 2.6 Sistemi për menaxhimin e riskut ujor	27000 0
Rezultati 3 – Rritja e ndërgjegjësimit	40000 0
Produkti 3.1 Zbatimi i fushatës për menaxhimin e burimeve ujore	25000 0
Produkti 3.2 Zhvillimi i programit që raporton aktivitetet e paligjshme në basenet e lumenjve	10000 0
Produkti 3.3 Zhvillimi i zgjidhjes digjitale për rritjen e transparencës dhe përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrje (ka mundësi nëpërmjet faqes së internetit)	50000
Monitorimi dhe nxënia	40000

Buxheti i aprovuar për AMBU-në është 112,580,000 LEK për vitin 2019. Krahas kësaj, AMBU-ja ka financim të huaj që kap shifrën e 93,000,000 LEKË. TVSH-ja dhe detyrimet doganore arrijnë shifrën 11,000,000 LEKË.

5.2 Mekanizmi i raportimit financiar

SHTOJCË 1

1.1 Fjalori

Impakti i pritshëm në planin afatgjatë, është një rezultat për të cilin do të kontribuojë projekti/programi (por nuk mund t'i atribuohet ndërhyrjes), përtej sferës së kontrollit dhe të influencës.

Rezultatet e pritshme afatmesme janë rezultatet e pritshme, për të cilat projekti / programi do të kontribuojë (por nuk mund t'i atribuohet ndërhyrjes), përtej sferës së kontrollit, por brenda sferës së ndikimit. Raportimi i përgjithshëm do të bëhet në këtë nivel.

Rezultatet e pritshme afatshkurtra, janë rezultatet e pritshme për të cilat pritet që të kontribuojë projekti/programi.

Produktet janë produktet ose shërbimet e ofruara. Pritet që të raportohet mbi produktet dhe mënyrën sesi lidhen me rezultatet e pritshme afatshkurtra.

Treguesi siguron mënyrën sesi ndërhyrja do të masë arritjen e rezultateve të pritshme. Treguesit duhet të jenë specifikë, të matshëm, të arritshëm, të përshtatshëm dhe për një afat kohor të caktuar (SMART).

Niveli bazë është pikënisja (vlera e indikatorit) për ndërhyrjen që lidhet drejtpërdrejtë me treguesit e përcaktuar (p.sh. 10% e pjesëmarrësve kuptojnë metodat bazë).

Burimet e verifikimit është hapësira ku mund të gjendet informacioni, p.sh. në një raport, faqe interneti, grup fokusi dhe sondazhi.

1.2 Korniza e rezultateve

Niveli i rezultatit	Përshkrimi	Indikatori	Niveli bazë	Burimi i verifikimit
Rezultati i pritshëm afatgjatë (Impakti)	Një zhvillim i qëndrueshëm i sektorit ujor (në përputhje me direktivat e BE-së, dhe prioritetet kombëtare) duke garantuar se AMBU-ja mund të mbështesë proceset vendimmarrëse të cilat janë në përfitim të zhvillimit mjedisor dhe socio-ekonomik (gjinia, përkatësia etnike, situata socio-ekonomike etj.)	Indikatorët e OZHQ: 6.5.1: Shkalla e zbatimit të menaxhimit të burimeve ujore (0-100) 6.5.2: Proporcioni i zonave të baseneve ndërkufitare që kanë marrëveshje pune për bashkëpunim në fushën e ujërave.	NA	NA

Rezultati pritshëm afatmesëm (qëllimi i projektit)	Transformimi i AMBU-së në një institucion plotësisht funksional, efektiv dhe efikas në përmbushje të detyrimeve ligjore, detyrave dhe përgjegjësi.	Për t'u zhvilluar		
Niveli i rezultatit	Përshkrimi	Indikatori	Niveli bazë	Burimi i verifikimit
Rezultati pritshëm afatshkurtër 1	Funksionim i përmirësuar i brendshëm i AMBU-së ndërmjet drejtorive, sektorëve dhe pozicioneve specifike	Ndryshimet dhe llojet e produkteve që ofrohen në kohë nga AMBU-ja		
Niveli i rezultatit	Përshkrimi	Indikatori	Niveli bazë	Burimi i verifikimit
Produkti 1.1	Zhvillimi, miratimi dhe komunikimi i planifikimit dhe organizimit strategjik të AMBU-së	Plani strategjik i pranuar Politika e adoptuar	Nuk ekziston asnjë plan strategjik Nuk ekziston asnjë politikë	Raporti i vlerësimit
Aktivitetet				
Analizon proceset dhe flukset e punës; Përgatit procedurat dhe përgjegjësitë; Analizon implikimet e mundshme ligjore, bën sugjerime për ndryshime; Zhvillon një strategji afatgjatë të AMBU-së (planin e punës) me TKP-të; Zhvillon politika gjinore për rekrutimin, mbajtjen dhe rritjen në detyrë sipas performancës dhe meritës (me synim shanse të barabarta të rritura) Zhvillon politika mjedisore si pjesë e funksionimit të brendshëm të agjencisë				
Niveli i rezultatit	Përshkrimi	Indikatori	Niveli bazë	Burimi i verifikimit
Produkti 1.2	Zhvillimi i procedurave për funksionimin e brendshëm, përfshirë përcaktimin e roleve dhe përgjegjësi	Ndryshimet dhe llojet e procedurave të zhvilluara	Procedurat formale të papërshtatshme Proceset e punës nuk janë të institucionalizuara	Raporti i vlerësimit
Aktivitetet				
Asistenca teknike përfshirë p.sh.: Analiza e proceseve ekzistuese; Zhvillimi i proceseve/procedurave dhe proceseve të punës (përfshirë analizën e proceseve) Formati për udhëzimet e punës Zhvillimi dhe komunikimi i përshkrimeve të punës Analiza e implikimeve të mundshme ligjore, sugjerimet për ndryshime Forcimi i kapaciteteve, p.sh.: Metodat përfshirëse për analizën e proceseve ekzistuese dhe zhvillimin e proceseve të reja Përdorimi i produkteve				
Niveli i rezultatit	Përshkrimi	Indikatori	Niveli bazë	Burimi i verifikimit
Produkti 1.3	Kapacitet i forcuar për të punuar me çështje ndërsektoriale, si pjesë e integruar e menaxhimit të burimeve ujore (në veçanti konflikti, barazia gjinore, ndryshimi i mjedisit/klimës)	Numri dhe% e stafit të AMBU të trajnuar (e ndarë sipas temave, pozicionit dhe seksit) Numri dhe% e stafit dhe menaxherëve që raportojnë ndërgjegjësim të rritur (të ndarë sipas temës, pozicionit, vendndodhjes dhe seksit) Llojet e ndryshimeve procedurale që janë	Njohuri të pakta mbi dobinë e çështjeve ndërsektoriale Përshkrime pune paraprake që marrin në konsideratë çështjet ndërsektoriale (gjinia) por duhet punë konkrete. Nuk ka staf aktualisht me mandat të qartë mbi çështjet	Vlerësimi i nevojave (përcaktimi i nivelit bazë) Anketim i aplikueshmërisë në vendet e punës

		kryer për të përmbushur nevojat (p.sh. procedurat e punës, përshkrimet e punës)	ndërsektoriale Mungesë e perspektivës së integruar në procedurat e punës.	
Aktivitetet				
Asistenca teknike: Përshkrimet e punës analizohen dhe zhvillohen me një qasje gjithëpërfshirëse, çfarë funksione të hallkës së punës duhen për të mbrojtur çështjet ndërsektoriale, Analizon implikimet ligjore, sugjeron ndryshime, Vlerësimi i nevojave mbi kapacitetet për të trajtuar çështjet ndërsektoriale, përfshirë nivelin e njohurive, sistemet ekzistuese, alokimin e burimeve, aksesin në mjete etj., dhe zhvillimin e rekomandimeve për kapacitet të rritur. Zhvillimi i kapaciteteve, në varësi të vlerësimit të nevojave, por p.sh.: Menaxhimi i konflikteve dhe zgjidhjet në lidhje me menaxhimin e burimeve ujore (me raste konkrete), Vlerësimi i impaktit social për investimet e mëdha (lidhja dhe të kuptuarit e standardeve/kërkesave mjedisore dhe sociale për investitorët e mundshëm) Lidhja midis menaxhimit të burimeve ujore dhe barazisë gjinore Komunikimi i jashtëm (shihni rezultatin 2)				
Niveli i rezultatit	Përshkrimi	Indikatori	Niveli bazë	Burimi i verifikimit
Produkti 1.4	Strukturat e komunikimit të brendshëm dhe sistemeve të zhvilluara për të mbështetur vendimmarrjen	Numri dhe% e stafit të AMBU-së të trajnuar (të ndarë sipas temave, vendndodhjes dhe seksit) Numri dhe% e stafit dhe menaxherëve që raportojnë përdorimin e procedurave (të ndarë sipas temës, pozicionit, dhe seksit) Llojet e ndryshimeve procedurale që janë kryer për të plotësuar nevojat (p.sh. procedurat e punës, përshkrimet e punës)	Ekziston një sistem informal	
Aktivitetet				
Asistenca teknike, p.sh. Përcaktimi i nevojave të komunikimit në lidhje me vendimmarrjen (dhe mjedisin e mirë të punës) Krijimi i sistemeve të brendshme dhe disiplinës që mundësojnë ndërveprim, koordinim, angazhim efikas dhe lehtësojnë komunikimin/ndërfaqen e strukturave të brendshme Vlerësimi i trajnimit Zhvillimi i kapaciteteve, p.sh.: Menaxhimi i konfliktit dhe zgjidhjes në vendin e punës – roli i komunikimit Procedura dhe sisteme të zhvilluara				
Niveli i rezultatit	Përshkrimi	Indikatori	Niveli bazë	Burimi i verifikimit
Produkti 1.5	Krijimi i infrastrukturës së duhur në AMBU	Numri i pajisjeve që janë siguruar (të ndara sipas vendndodhjes, për cilin pozicion, përfshirë seksin e stafit)	Të caktohet në fazën fillestare	Raporti i inventarit të infrastrukturës Analizë mbështetëse mbi përdorimin e pajisjeve
Aktivitetet				
Zhvillimi i specifikimeve të pajisjeve				
Prokurimet				

Niveli i rezultatit	Përshkrimi	Indikatori	Niveli bazë	Burimi i verifikimit
Rezultati i pritshëm afatshkurtër 2	Përmirësimi i funksionimit dhe ndërveprimit të jashtëm të Agjencisë me aktorët e tjerë sektorialë			
Niveli i rezultatit	Përshkrimi	Indikatori	Niveli bazë	Burimi i verifikimit
Produkti 2.1	Zhvillimi i komunikimit të jashtëm strategjik (<i>as a frame for the following Produktis</i>)	Numri dhe% e stafit AMBU që është trajnuar (të ndarë sipas temës, pozicionit, vendndodhjes dhe seksit) Numri dhe% e stafit dhe menaxherëve që raportojnë ndërgjegjësim të rritur (të ndarë sipas temës, pozicionit dhe seksit) Numri i ndryshimeve procedurale që duhen bërë për të plotësuar nevojat (si përshkrimet e punës, procedurat e punës)	Nuk ka strategji Niveli i konsultimeve publike që kryhen Njohuri të pakta mbi dobinë e shpërndarjes dhe komunikimit strategjik Nuk ka staf që të trajtojë atë që do të jetë nevojë në rritje për komunikim	Strategjia Raporti i vlerësimit Anketim mbi ndërgjegjësimin
Aktivitetet Analizon materialin e strategjisë MIBU dhe të RBMP mbi angazhimin e aktorëve dhe metodat e shpërndarjes; Zhvillon procedura për angazhim me aktorë të ndryshëm Zhvillon procedura për angazhim më të gjerë për të garantuar përfshirje të barabartë të grave, burrave, vajzave dhe djemve në vendndodhje të ndryshme gjeografike (përfshirë OJQ lokale, si OJQ-të e grave dhe ato të mjedisit); Zhvillon/përgatit metodat ekzistuese pjesëmarrëse për takimet me publikun (me synim të qartë të rrisë pjesëmarrjen e femrave) Analizon fluksin e punës për procese të ndryshme angazhimi Vlerësimi i nevojave për trajnim Forcimi i kapaciteteve si në: Komunikim strategjik Përfshirje sociale dhe pjesëmarrje e barabartë gjinore Përgatitja e ToR për sektorin e ujërave duke pasur parasysh angazhimin e gjerë Shtrirje strategjike dhe fushata për grupet e synuar (si të kontaktohen djemtë e rinj, gratë e moshuara)				
Niveli i rezultatit	Përshkrimi	Indikatori	Niveli bazë	Burimi i verifikimit
Produkti 2.2	Forcimi i angazhimit të Kryeministrit, KKKU, GIMP, Komiteteve strategjike dhe Komisioneve Ndërkufitare	Numri i pikave të kontaktit (të ndarë sipas seksit dhe llojit të aktorit) % rritje në komunikimin profesional (të ndarë sipas pozicionit, seksit dhe aktorit)	Nuk ka pika kontakti për angazhimin e AMBU-së	Informacion nga aktorët, procesverbali i takimeve Anketim në lidhje me strategjinë e përgjithshme të komunikimit
Aktivitetet Identifikimi dhe vlerësimi i aktorëve; Përcaktimi i pikave të kontaktit dhe përkufizimi i funksionit për secilin aktor; Formulimi i angazhimit, ndërveprimit dhe proceseve/procedurave të komunikimit (pjesë e strategjisë së përgjithshme të komunikimit)				
Niveli i rezultatit	Përshkrimi	Indikatori	Niveli bazë	Burimi i verifikimit

Produkti 2.3	Bashkëpunim i përmirësuar me njësitë e qeverisë vendore, ZABU, komunitetet dhe qytetarët	Numri i pikave të kontaktit (të ndara sipas seksit dhe llojit të aktorit)	Nuk ka pika kontakti për angazhimin e AMBU-së	Informacioni nga aktorët, procesverbalet e takimit
		% rritje në komunikim profesional (të ndarë sipas pozicionit, seksit dhe llojit të aktorit)		Anketim që lidhet me strategjinë e përgjithshme të komunikimit
	Aktivitetet Identifikimi dhe vlerësimi i aktorëve; Përcaktimi i pikave të kontaktit dhe caktimi i përgjegjësive; Formulimi i ndërveprimit dhe procesit/procedurës së komunikimit (pjesë e strategjisë së përgjithshme të komunikimit).			
Niveli i rezultatit	Përshkrimi	Indikatori	Niveli bazë	Burimi i verifikimit
Produkti 2.4	Ndërveprim i përmirësuar i AMBU-së me përdoruesit e ujit	Numri i lejeve të përpunuara (të ndara sipas sektorit dhe aktorëve)	Statusi aktual i paqartë, por një numër lejesh nuk përpunohen në kohë (të përcaktohet)	ZABU i raporton AMBU mbi proceset e lejeve
	Aktivitetet Zhvillimi i sistemit të lejeve / autorizimeve për 4 grupet e përdoruesve të ujit: përfshirë sigurimin / rregullimin e të drejtave mbi përdorimin e ujit, riorganizimin e procesit të lejeve, miratimin e ndryshimeve ligjore, forcimin e kapaciteteve në sistemin e ri, krijimin e infrastrukturës dhe teknologjisë për realizimin e procesit; Zhvillimi i sistemit të vlerësimit të performancës së përdoruesve të ujit: përfshin prioritizimin e përdorimit të ujit, vlerësimin e sasisë dhe cilësisë së ujit para dhe pas përdorimit, analizën e performancës, produktivitetin dhe vlerën ekonomike të përdorimit të ujit, harmonizimin me direktivat e BE-së dhe pëmbushjen e përgjegjësive që lidhen me cilësinë dhe efikasitetin e përdorimit të ujit. Në këtë kontekst është e rëndësishme për të kuptuar, sqaruar dhe zbatuar siç duhet përgjegjësitë institucionale që rrjedhin nga direktiva kuadër e ujërave dhe direktiva të tjera plotësuese dhe specifike që kanë të bëjnë me burimet ujore; Zhvillimi i sistemit të monitorimit të ujit: monitorimi i sasisë dhe cilësisë së ujit para dhe pas përdorimit, caktimi i tarifave të ujit, mbledhja e të ardhurave, për secilën prej 4 kategorive kryesore të përdorimit të ujit			
Niveli i rezultatit	Përshkrimi	Indikatori	Niveli bazë	Burimi i verifikimit
Produkti 2.5	Sqarimi i roleve dhe ndërveprimi me komponentin e mjedisit dhe aktorët që japin kontributin e tyre për rregullimin e burimeve ujore			
	Aktivitetet Asistenca teknike: Zhvillimi dhe sqarimi i roleve (shihni edhe 2.2)			
Niveli i rezultatit	Përshkrimi	Indikatori	Niveli bazë	Burimi i verifikimit
Produkti 2.6	Krijimi i sistemit për menaxhimin e riskut nga uji (mungesë ose tepriçë uji)			
	Aktivitetet Identifikimi dhe vlerësimi i risqeve; Analiza dhe përcaktimi i masave zbutëse; Përkufizimi i roleve dhe përgjegjësive të aktorëve për t'iu përgjigjur situatave emergjence dhe në lidhje me zbatimin e masave zbutëse; Monitorimi i riskut dhe ndërhyrja në rast se ndodh.			
Niveli i rezultatit	Përshkrimi	Indikatori	Niveli bazë	Burimi i verifikimit

Rezultati i pritshëm afatshkurtër 3	Nivele të rritura ndërgjegjësimi për përdorim të sigurt, të barabartë dhe ligjërish të pranueshëm të burimeve ujore	Numri i personave që raportojnë se kanë njohuri për fushatat e kryera dhe mesazhet kryesore (të ndara sipas seksit, moshës, vendndodhjes)	Të përcaktohet	Raporti i anketimit
Niveli i rezultatit	Përshkrimi	Indikatori	Niveli bazë	Burimi i verifikimit
Produkti 3.1	Zbatimi i fushatës së menaxhimit të burimeve ujore	Numri i personave që janë kontaktuar drejtpërdrejtë (të ndarë sipas grup-moshës, si studentët në universitete etj.)	0	Raporti i fushatës
Aktivitetet Përgatitja e nivelit bazë për ta shpërndarë dhe teksti i materialit për grupet e synuara (si burra, gra, vajza e djem në zona rurale/urbane – në varësi të grupit të synuar) Formulimi dhe prodhimi i broshurave informative për çështjet që lidhen me ujërat në Shqipëri; Vendoset se ku është më mirë të shpërndahet ky material për të siguruar se do të mbërrijë në grupin e synuar (p.sh. nëse janë gratë një grup specifik i synuar, atëherë kjo duhet marrë parasysh kur shpërndahet materiali). Përgatit dhe zhvillon një fushatë ndërgjegjësimi për ujërat dhe fushatë veprimi në universitete; Përgatit dhe zhvillon një fushatë ndërgjegjësimi për ujërat dhe fushatë veprimi në shkollë; Përgatit dhe zhvillon një fushatë ndërgjegjësimi për ujërat dhe fushatë veprimi për komunitetet në zonat bregdetare;				
Niveli i rezultatit	Përshkrimi	Indikatori	Niveli bazë	Burimi i verifikimit
Produkti 3.2	Zhvillimi i programit që raporton aktivitetet e jashtëligjshme në basenet ujore	Numri dhe lloji i raporteve të incidenteve (të ndara sipas informacioneve të identifikuar dhe informacioneve anonime)	Të përcaktohet por meqë nuk ekzistojnë kanale të qarta për këtë raportim, kjo duhet vlerësuar me 0	Raportet të prodhohen nga softueri.
Aktivitetet Identifikimi dhe përcaktimi i informacionit që do të hidhet në sistem; Identifikimi dhe vlerësimi i moduleve që duhet të ketë sistemi; Dizënjimi i sistemit; Përcaktimi dhe ulja e formës së raportimit; Shpërndarja (p.sh. nëpërmjet fushatës të produkti 3.1 dhe 3.3, krijimi i mekanizmit të raportimit)				
Niveli i rezultatit	Përshkrimi	Indikatori	Niveli bazë	Burimi i verifikimit
Produkti 3.3	Zhvillimi i një zgjidhjeje digjitale për të rritur transparencën dhe përfshirjen e qytetarëve në vendim-marrje duke përdorur një mjet digjital.	Numri i vizitave % rritje e vizitave Numri i aktorëve kryesorë që përdorin faqen e internetit Numri i aktorëve jo kyç (e klikimeve të tjera) që përdorin faqen e internetit (të ndarë sipas llojit të informacionit që kërkohet)	Ka faqe interneti por nuk përfshin ZABU, nuk është e lidhur me Kadastrën Kombëtare të Burimeve Ujore Mungesa e aksesit në informacion, ndarja e mjetit me publikun	Faqja e përditësuar e internetit Google Analytics
Aktivitetet Dizënjimi i faqes së internetit si strukturë e re për të mundësuar informacion publik më të strukturuar, mbështetur mbi mënyrën sesi punon Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore; Vlerësimi dhe përfshirja e informacionit mbi shërbimet që ofron Agjencia e Menaxhimit të				

	Burimeve Ujore; Përfshirja e zyrave të administrimit të baseneve ujore si pjesë e strukturës së AMBU-së; Lidhje me platformën e Kadastrës Kombëtare të Burimeve Ujore.
--	--

SHTOJCË B
BUXHETI: FORCIMI INSTITUCIONAL I AMBU-së

Matrica më poshtë përmban një vlerësim paraprak të nevojave buxhetore për secilin nga produktet e parashikuar, mbështetur në përvojën e subjektit propozues dhe punëve të ngjashme. Një vlerësim më i hollësishëm është vendosur të përgatitet gjatë fazës fillestare të projektit, meqë kërkon më shumë informacion dhe analizë për të zbërthyer secilin nga produktet.

	Buxheti (€)
Buxheti total (Rezultati 1, 2, 3 dhe monitorimi)	1,910,000 SEK 19 700 000
Rezultati 1 – funksionimi i brendshëm	535000
Faza fillestare (planifikimi, aprovimi, prokurimi, vënia në përdorim)	5000
Produkti 1.1 Zhvillimi, pranimi dhe komunikimi i planifikimit strategjik dhe organizimit të AMBU-së	90000
Produkti 1.2 Zhvillimi i procedurave për funksionimin e brendshëm, përfshirë përcaktimin e roleve dhe përgjegjësi	160000
Produkti 1.3 Forcimi i kapacitetit për të punuar me çështje ndër sektoriale si një pjesë e integruar e menaxhimit të burimeve ujore (në veçanti konflikti, barazia gjinore, ndryshimi i mjedisit dhe klimës)	40000
Produkti 1.4 Zhvillimi i strukturave të brendshme të komunikimit dhe sistemeve për të mbështetur procesin vendimmarrës	40000
Produkti 1.5 Infrastruktura e duhur në AMBU (vetëm struktura e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit)	100000
Rezultati 2 – funksionimi i jashtëm	935000
Faza fillestare (planifikimi, aprovimi, prokurimi, vënia në përdorim)	5000
Produkti 2.1 Planifikimi i komunikimit strategjik dhe zhvillimit të kapaciteteve	40000
Produkti 2.2 Përforsimi i pozicionit të AMBU-së dhe bashkëpunim më të madh me Kryeministrin, KKKU, GMIP, Komitetet Strategjike dhe Komisionet Ndërkufitare	100000
Produkti 2.3 Përmirësim të bashkëpunimit me njësitë e qeverisjes vendore, ZABU-të, komunitetet dhe qytetarët	120000
Produkti 2.4 Ndërveprim i AMBU-së me përdoruesit e ujit	250000
Produkti 2.5 Përcaktimi i roleve dhe ndërveprimi me komponentin e mjedisit dhe aktorët që japin kontributin e tyre për qeverisjen e burimeve ujore	150000
Produkti 2.6 Sistemi për menaxhimin e riskut të ujit	270000
Rezultati 3	400000
Produkti 3.1 Zbatimi i fushatës së ndërgjegjësimit menaxhimit të burimeve ujore	250000
Produkti 3.2 Zhvillimi i një softueri ku raportohen aktivitetet e jashtëligjshme në basenet ujore	100000

Produkti 3.3 Zhvillimi i një zgjidhjeje digjitale për të rritur transparencën dhe përfshirjen e qytetarëve në vendimmarrje (me shumë mundësi nëpërmjet një faqeje interneti)	50000
Monitorimi dhe mësimi	40000

Versioni 1.0 i gushtit 2018

SHTOJCË C

TERMAT STANDARDË TË REFERENCËS SË SIDA-S PËR AUDITIMIN VJETOR TË MBËSHTETJES SË PROJEKTT/PROGRAMIT

Teksti me të kuqe është tekst ndihmues dhe duhet të fshihet përpara se termat e referencës t'i bashkëngjiten marrëveshjes. Teksti blu është tekst që duhet të zëvendësohet.

Zëvendëso [partnerin e bashkëpunimit] me emrin e partnerit të bashkëpunimit, si dhe tekstin tjetër të shënuar me ngjyrë blu.

Prezantimi

Prezantim i shkurtër i [Partnerit të Bashkëpunimit], referuar në vijim si 'Partneri i Bashkëpunimit':

Partneri i Bashkëpunimit dëshiron të angazhojë shërbimet e një firme auditimi me qëllim auditimin e [emrit të projektit/programit], siç përcaktohet në marrëveshjen ndërmjet partnerit të Bashkëpunimit dhe Sida. Auditimi do të kryhet në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit të përcaktuara nga IAASB2. Auditimi kryhet nga një auditues i jashtëm, i pavarur dhe i kualifikuar.

I. Objektivat dhe qëllimi i auditimit

Qëllimi është të auditohet raporti financiar për periudhën [viti-muaji-dita deri në viti-muaji-dita] siç është paraqitur në Sida dhe të jepet një opinion të auditimit sipas ISA 800/805, nëse raporti financiar i [emrit të projektit/programit] është në përputhje me udhëzimet e Sida-s për raportimin financiar siç është përcaktuar në marrëveshje, duke përfshirë edhe shtojcën ndërmjet SIDA-s dhe partnerit të Bashkëpunimit.

II. Detyrat shtesë; sipas procedurave të dakordësuara të ISRS 4400, shqyrtoni fushat e mëposhtme në përputhje me termat e referencës më poshtë

Listoni çdo fushë shtesë që do të ekzaminohet nga audituesi, p.sh. duke ndjekur dobësitë e identifikuar në auditime të mëparshme me efikasitet apo inspektimet mbi menaxhimin e brendshëm dhe kontrollin. Vëreni se, nëse buxheti përfshin kostot e pagave që do ti debitohen projektit/programit, të dakordësuara nga procedurat sipas ISRS 4400 (për informacion në lidhje me ISRS 4400 si një standard, shiko Manualin e Auditimit) do të duhet të kryhen gjithmonë dhe të përfshijnë një inspektim nëse këto kosto janë regjistruar në mënyrë sistematike e cila lejon ndjekje të vazhdueshme. Përmasat e modelit që audituesi duhet të rishqyrtojë nën një detyrë shtesë lidhur me përcjelljen e fondeve, do të përcaktohet në termat e referencës ose në shkresën e angazhimit ndërmjet audituesit dhe partnerit të bashkëpunimit.

Fushat e inspektimit më poshtë janë ndarë në të detyrueshme dhe detyra shtesë fakultative. Përveç këtyre, mund të përfshihen gjithashtu detyra të tjera shtesë, bazuar në çka është e nevojshme dhe e përshtatshme në kontributin specifik. Konsultohuni me kontrollorin tuaj lidhur me fushat përkatëse të inspektimit.

Detyrat e detyrueshme që duhet të përfshihen:

1. Të ndiqet nëse shpenzimet e pagave të debituar ndaj projektit/programit janë regjistruar gjatë gjithë kohëzgjatjes së vitit në mënyrë sistematike dhe kontrolloni nëse shpenzimet e pagave mund të verifikohen me dokumentacion të mjaftueshëm mbështetës.

² Bordi Ndërkombëtar i Auditimit dhe Standardeve të Sigurisë (BSNAS/IAASB)

2. Të kontrollohet nëse raporti financiar përfshin një krahasim, për çdo zë të buxhetit, ndërmjet kostove/shpenzimeve aktuale të aktiviteteve dhe kostove/shpenzime të buxhetit siç është miratuar nga Sida për periudhën.

3. Bazuar në materialitetin dhe rrezikun, audituesi duhet të kontrollojë nëse ka dokumentacion mbështetës lidhur me shpenzimet e shkaktuara. Pavarësisht materialitetit të gjetjeve, audituesi duhet të përcaktojë shumën për kostot që nuk kanë dokumentacion të mjaftueshëm mbështetës.

4. Të kontrollohet nëse fitimet/humbjet nga shkëmbimet në valutë të huaj janë vendosur si një zë i veçantë në raportin financiar, si dhe janë shfaqur në përputhje me atë që është përcaktuar në marrëveshje duke përfshirë shtojcat dhe parimet e kontabilitetit të pranuar gjerësisht.

5. Pajtueshmëria e partnerit të bashkëpunimit me legjislacionin tatimor në fuqi në lidhje me taksat (p.sh. PAYE) 3 dhe tarifat e sigurimeve shoqërore.

6. Të ndiqet nëse partneri i bashkëpunimit ka respektuar udhëzimet e prokurimit të aneksuara ose të përmendura në marrëveshje.

7. Të shqyrtohet nëse bilanci dalës për periudhën e mëparshme është i njëjtë me bilancin hyrës për periudhën aktuale.

8. Nëse partneri i bashkëpunimit aplikon bazën e modifikuar të parasë së thatë si parim kontabiliteti, audituesi do të përshkruajë metodën e përdorur dhe do të motivojë nëse parimi i kontabilitetit të aplikuar është i pranueshëm për këtë lloj raporti financiar.

9. Të verifikohet gjendja e pashpenzuar në fund të vitit financiar kundrejt të dhënave të kontabilitetit dhe dokumentacionit të tij mbështetës.

10. Të verifikohet balanca e pashpenzuar që do t'i rikthehet Sida-s në raportin përfundimtar të vitit të fundit të marrëveshjes. (Aplikohet vetëm në raportin përfundimtar të vitit të fundit të marrëveshjes).

Detyrat fakultative që duhet të përfshihen kur është e aplikueshme:

- Të ndiqet nëse partneri i bashkëpunimit ka zbatuar rekomandimet e mëposhtme nga vlerësimi i kontrollit të brendshëm: , dhe . Kontrolli përfshin inspektimin nëse partneri i bashkëpunimit ka zbatuar pikat e veprimit siç përshkruhet në përgjigjen e menaxhimit të partnerit të bashkëpunimit, që i është paraqitur Sida-s.

- Detyra të tjera shtesë?

III. Raportimi

Raportimi duhet të nënshkruhet nga audituesi përgjegjës (jo vetëm firma e auditimit) dhe duhet të përfshijë titullin e audituesit përgjegjës.

Raportimi nga audituesi duhet të përfshijë një raport të pavarur të audituesit në përputhje me formatin e standardit ISA 800/805 dhe opinioni i audituesit duhet të shprehet qartë. Raporti i audituesit të pavarur të përcaktojë qartë se auditimi është kryer në përputhje me ISA 800/805. Raportimi gjithashtu duhet të përfshijë një shkresë Menaxhimi që shfaq të gjitha gjetjet e auditimit (të rëndësishme dhe gjetje të tjera), si dhe dobësitë e identifikuara gjatë procesit të auditimit. Raporti financiar që ka qenë objekt i auditimit i bashkëngjitet raportit të auditimit. Audituesi duhet të bëjë rekomandime për të adresuar gjetjet dhe dobësitë e identifikuara. Rekomandimet duhet të paraqiten në rend përparësie.

Nëse audituesi vlerëson se gjatë auditimit nuk janë identifikuar gjetje apo dobësi që do çonin në një Shkresë Menaxhimi, një shpjegim i këtij vlerësimi duhet të shfaqet në raportimin e auditimit.

Masat e marra nga organizata për të adresuar dobësitë e identifikuara në auditimet e mëparshme gjithashtu do të paraqiten në Shkresën e Menaxhimit.

Detyra shtesë, sipas procedurave të dakordësuara të ISRS 4400 sipas nenit II, do të raportohet veçmas në “Raportin e gjetjeve faktike”. Madhësia e modelit të raportimit të auditimit të rishqyrtuar do të deklarohet në raport.

³ Paguaj sa fiton.

Nëse audituesi kryen një detyrë shtesë sipas ISRS 4400 dhe vlerëson se vëzhgimet e paraqitura në “Raportin e gjetjeve faktike” përfshijnë informacionin që duhet të ishte përfshirë në një shkresë menaxhimi, nuk është e nevojshme të lëshohet një shkresë menaxhimi e veçantë për detyrën e ISRS 4400. Në vend të kësaj, mjafton që “Raporti i gjetjeve faktike” të përfshijë një shpjegim se pse nuk është lëshuar një shkresë menaxhimi.